



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 558/2025

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e shtatë -VII- të rregullt për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 31.07.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2025.
3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2024.
4. Plan i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2024.
5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.
6. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Informatë për sektorin e emergjencave.
8. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Qershor 2025.
- Materialin e raportit të auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2024.
- Materialin e planit të Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2024.
- Materialin e informatës për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Qershor 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
- Materialin e informatës për sektorin e emergjencave.

Hani i Elezit
Data:-23.07.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



5579

01/Nr. ____/2025
Data: 23.07.2025

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e gjashtë -VI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 26.06.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028.
3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksionit të hyrave vetanake për vitin 2025.
5. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore investime kapitale.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:-kërkoj që në rend të punës të hynë edhe një pikë shtesë, propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012 që është vendim për pagesën e shpenzimeve të vorrimit, propozimi për pagesën e arkivoleve për veteranët e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për shkak se kemi problem me pagesën sepse përmes organizatës së veteranëve nuk mundemi dhe duhet që pagesën me ja kryer përmes Bashkësisë Islame dega në Han të Elezit

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim sa i përket rendit të punës, nëse nuk ka propozimin e Kryetarit të Komunës e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028.
3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksonit të të hyrave vetanake për vitin 2025.
5. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore investime kapitale.
6. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012.
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- për vitin 2026 buxheti parashikohet që të jetë në shumë 4,234,682.00 €. Për vitin 2027 buxheti parashikohet që të jetë në shumë 4,457,136.00 €. Për vitin 2028 buxheti parashikohet që të jetë në shumë 4,672,491.00 €. Sa i përket vitit 2026 të gjitha projeksonet e financimit kanë një rritje dhe kjo tendencë e rritjes do të vazhdon edhe në vitin 2027 dhe në vitin 2028. Për vitin 2026 granti i përgjithshëm do të jetë në lartësi prej, 1872 179.00 € apo një rritje prej 170,287.00 € në krahasim me vitin 2025. Granti specifik i arsimit shënon rritje në vitin 2026 parashikohet të jetë në shumë prej 1,429,646.00 € apo një rritje prej 262,012.00 € në krahasim me vitin 2025. Granti specifik i shëndetësisë është në shumë prej 576,137.00€ për vitin 2026 ku kemi një rritje në krahasim me vitin 2025 për 169,925.00 €. Të hyrat vetanake komunale për vitin 2026 parashikohen të jetë në lartësi prej 356,720.00 € apo një rritje prej 17,001.00 € apo 5.0 % në krahasim me vitin 2025, ndërsa për vitin 2027 parashikohen të jenë në lartësi prej 383,895.00 € apo një rritje prej 27,175.00 € apo prej 7.6% krahasur me vitin 2026, ndërsa për vitin 2028 kemi një vlerësim prej 385,721.00 € apo një rritje prej 1,826.00 € apo prej 0.4% në krahasim me vitin 2027. Me qarkoren buxhetore kemi të aprovuar trembëdhjetë pozita të reja në sektorin e shëndetësisë, katër prej tyre janë të përcaktuara nga niveli qendrorë, ndërsa pjesa tjetër mund të planifikohet varësisht prej nevojave të sektorit të shëndetësisë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2026-2028

3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- në komitet për politikë e financa jemi dakorduar që në grup punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të jenë anëtarët e komitetit për politikë e financa.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2026

4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- mjetet financiare të cilat e kanë tejkaluar projeksionin e të hyrave vetanake kërkojmë që ky tejkalim të alokohet në kuadër të disa nënprogrameve dhe kategorive buxhetore. Projeksiioni i të hyrave vetanake për vitin aktual është në shumë prej 339719.00 € dhe ne e kemi kaluar këtë projeksion prej muajit janar deri me datë 05.06.2025 nga të hyrat direkte dhe indirekte 1098,944.32 €. Përmbushja e planifikimit buxhetor me financim nga të hyrat vetanake është realizuar në shumë prej 339,719.00 €. Pjesa tjetër është në shumë prej 759, 225.32 € që kërkoj nga ju për aprovim për me u flokuar në programe dhe kategori buxhetore . Kemi pasur një rekomandim nga departamenti i buxhetit i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që propozim vendimi i tejkalimit të parë dhe tejkalimi i dytë i të hyrave vetanake të alokohen me një vendim që të dyat përfshijnë shumën në vlerë prej 759, 225.32 €.

Sherif Berisha thekson:- kam marr fjalën për të shprehur një shqetësim për një çështje jashtëzakonisht për mënyrës se si po planifikohen mjetet shtesë të buxhetit komunal rrjedhimisht nga deklaremt e të hyrave vetanake për vitin 2025. Sipas dokumenteve zyrtare që kemi pranuar si asamblistë është evidentuar një tejkalim në shumë prej 759, 225.32 €. Fatkeqësisht propozimi aktual që e kemi para vetës gjashtëdhjetë përqind e këtyre mjeteve do të shqezohen në mallra e shërbime dhe subvencione , kategori që kanë efekt afat shkurtër dhe që nuk lënë ndikim të qëndrueshëm në jetën e qytetarëve tonë. Koleg të nderuar mjetet buxhetore duhet të orientohen drejtë projekteve kapitale që sjellin ndikim të matshëm dhe të qëndrueshëm. Investime në infrastrukturë rrugore, përmirësimin e kushteve në shkolla dhe qendra shëndetësore, mbështetje për projekte që nxisin zhvillimin ekonomik lokal dhe turizmin dhe mbi gjitha përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve tonë në çdo lagje dhe fshatra. Ndarja aktuale përkundrazi përqonë mesazhin se interesi afat shkurtër po mbizotronë ndaj nevojës për zhvillim të qëndrueshëm. Ne ta themi troqë kjo ndarje buxhetore në këtë kohë kritike ngjallë dyshime serioze për përfitime elektorale. Si përfaqësues të qytetarëve nuk mund të heshtim kur ekziston rreziku i keqpërdorimit të parasë publike për qëllime politike. A është e drejtë që mjetet që i takojnë gjithë qytetarëve të përdoren për shpenzimet që ju shërbejnë afateve politike e jo interesave afatgjate të komunitetit. Nëse veprojmë kështu atëherë e kemi tradhtuar votuesin tanë dhe për këtë askush nuk ka mandat. Po ashtu kam një kërkesë konkrete për ekzekutivin që ti publikoni sa më parë shifrën e saktë të obligimeve financiare të komunës ndaj operatorëve ekonomikë qoftë nga kontrata e nënshkruar, vendimet e kuvendit apo marrëveshjet e më hershme , vetëm me këtë informacione ne mund të marrim vendime të informuara të balancuara dhe të përgjegjshme. Pa e ditur këtë pasqyrë të qartë çdo ndarje buxhetore është e pa plotë dhe potencialisht e rrezikshme, prandaj në emër të përgjegjësisë si institucionale dhe në emër të Lëvizjes Vetëvendosje sot kërkoj dhe propozoj që të shtyhet ky vendim për ndarjen e mjeteve publike deri me një mbledhje tjetër në mënyrë që të gjithë bashkë ty shqyrtojmë më mirë bartjen e këtyre mjeteve , të organizohen

dëgjime publike me qytetarët dhe përfaqësuesit e komunitetit për të përcaktuar bashkarishtë prioritete e financimit. Ne nuk jemi këtu për të ndarë buxhetet në emër të qytetarëve por ne duhet ta ndajmë atë me pjesëmarrjen e tyre. Të rishikohet ndarja buxhetore me fokus të qartë në rritjen e përqindjes së investimeve kapitale që sjellin përfitime të drejtë për drejta e të qëndrueshme. Të nderuar kolegë dhe kolege të këtij kuvendi para se të ngrejmë dorën për të miratuar një vendim të tillë apo veproni me besimin që na e kanë dhënë qytetarët, a jemi duke e mbrojtur interesin publik apo po e deformojmë atë për qëllime afat shkurtër. Këtë diskutim dua ta përfundoj me një mesazh shumë të shkurtër për u dhe për të gjithë që na shikojnë dhe na dëgjojnë, buxheti komunal nuk është pronë e askujt që ndodhet në pushtet është pronë publike dhe menaxhimi tij duhet të bëhet me drejtësi, transparencë dhe vizion për të ardhmen, andaj sot nga kjo foltore ju bëjë thirrje çdo anëtarë të këtij kuvendi, çdo kolegë që do votojë me ndërgjegje të kenë guximin dhe të jenë kundër këtij vendimi i cili në vete ka vetëm kalkulime.

Mehmet Ballazhi thekson:-çështja politike në ndarjet buxhetore nuk qëndron se ne jemi në fazën e dëgjimeve buxhetore në vitet vijuese , kjo shumë e këtyre mjeteve që e ka bërë një tejkalim të projeksioneve buxhetore të të hyrave ju e din që është për shkak të shpronësimit që ka qenë që më herët dhe në këtë vit i kanë përcjell mjetet financiare dhe aty është shuma mbi gjashtë mijë euro. Këtë shumë siç potencove për me shpërnda nëpër projekte në shkolla, në shëndetësi në fakt kështu e kemi ndarë dhe e fundit e fundit është një dokument të cilin keni me miratuar ju sepse e kemi dërguar si draft e ju si anëtarë të kuvendit e kontrolloni dhe e diskutoni, pastaj mund t'i keni kërkesat, vërejtjet dhe propozimet nëse nuk është përcaktuar mirë sipas mendimit tonë. Materialin e keni parë dhe me potencuar që kjo të shtyhet për një mbledhje tjetër nuk është mirë . Unë po mundohem me t'i treguar pasojat nëse shtyhet për një mbledhje tjetër . U potencia që pse në mallra dhe shërbime unë them që ka në mallra dhe shërbime , ka në projekte , në subvencione që ne kemi menduar që shkon në interes të qytetarëve në kërkesat të cilat i kanë pasur. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve e kemi kontratën kolektive , brenda dy muajve përmbaruesi merr mjete financiare nga projektet në projeksionet buxhetore që janë gati në implementim, herën e parë kanë ndodhur nga shërbimet publike, nga subvencionet e studentëve , nga arsimi që kanë qenë tabelat digjitale. Ne duhet t'i rimbursojmë dhe për mos me shkuar deri të lëndët tjera përmbarimore që mund të duplikohen nga operatorët ekonomik, nga kompanitë që realizojnë projekte dhe ideja për me i dedikuar në mallra dhe shërbime është për shkak se pagesa mund të kryhet përmes mallrave dhe shërbimeve për shkak se nuk kemi asnjë mundësi ligjore me i paguar përmes pagave dhe mëditjeve. Sa i përket aspektit politik askush nuk është këtu me bërë politikë me buxhetin e qytetarëve por ne jemi të obliguar me shpërndarë buxhetin e ju jeni ata që keni me miratuar se ne vetëm kemi bërë propozim dhe ju nëse e shihni të arsyeshme që i plotëson kërkesat por mund të potenconi se nëse ky projekt është për interesa të qytetarëve ne e propozojmë me një kategori tjetër buxhetore, mirëpo me u shtyer pa ndonjë sqarim që me marr kohë kjo është zhegitje e proceseve. Ne i kemi tabelat digjitale që është dashur me implementuar projektin por u dashtë në kuvend me proceduar për me implementuar projektin. Këto janë problemet që na e kemi shpërndarë në këtë mënyrë dhe nëse keni diçka konkretisht mundë ta propozoni por nëse kërkon me shtyer afatin është shtyerje e kohës për ekzekutim.

Lindita Ballazhi thekson:-u potencia që të publikohen të gjitha borxhet e operatorëve ekonomikë por ju informojë që ta vizitoni vebfaqën zyrtare të komunës dhe aty janë të publikuara borxhet publike të komunës për çdo muaj.

Sherif Berisha thekson:- ajo që dua të them që sikur kemi bashkëpunuar te Korniza Afatmesme Buxhetore pse nuk ishte e mundshme me biseduar edhe për këtë sepse këtu na është dërguar shuma prej 60 % e mjeteve që shkojnë në mallra shërbime dhe subvencione sepse ne i dimë gjitha problemet që janë evidente por ka pasur mundësi të diskutojmë se ku do të dedikohen këto mjete

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte 10 për , 1 kundër, 3 abstenim.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR RITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS HANI I ELEZIT NGA TEJKLIMI I PROJEKSIONIT TË TË HYRAVE VETANAKE

5. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore investime kapitale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:-ky rialokim është propozuar që të jetë në tre nën-programe buxhetore që do të bëhet prej fondit burimorë dhjetë apo grandit qeveritarë dhe shuma totale është 34, 500.00 €.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE INVESTIME KAPITALE

6.Propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:-në fillim u mundova për me sqaruar dhe është mirë që të miratohet sepse edhe ata kanë probleme me pagesat e arkivoleve për rastet e vdekjeve të veteranëve dhe ka qenë kërkesë e tyre dhe nëse ju e miratoni do të ishte mirë sepse këtë barrë nuk mundte me kryer Organizata e Veteranëve të Luftës.

Sherif Berisha thekson:- si Lëvizje Vetëvendosje jemi pro i këtij vendimi do ta votojmë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.469/2021

7.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:-nga drejtoresha e kulturës kërkoj raport financiar për vitin e fundit për këtë vit për të gjitha klubet sportive që subvencionohen prej komunës. Te tabelat digjitale sipas informacioneve të mia nuk janë më shumë se tri tabela digjitale . Sa i përket projektorëve janë vetë dy projektorë në shkollën fillore “Ilaz Thaçi” , kërkoj sqarim se si është gjendja me projektorë nëpër shkolla.

Zaim Bela thekson:- pyje kam për çështjen që lidhet me punonjësit publik përkatësisht për borxhet që burojnë nga kontrata kolektive në sektorin e arsimit , shëndetësi dhe shërbyesve civil, pra ekziston një shifër e saktë e zyrtarëve për borxhet e mbetura ndaj zyrtarëve të arsimit , borxhet ndaj punëtorëve të sektorit të shëndetësisë, borxhet ndaj shërbyesve civil në nivel të komunës. Nga komunikimi me punonjësit publik kam informacione se një pjesë e punonjësve në komunë kanë marr mjete financiare përmes procedurave gjygsore, përmbaruesve ose vendimeve nga thesari që bëhet fjalë për shujtat që një pjesë janë në pritje e disa nuk kanë mundur fare të përfitojnë sepse lëndët e tyre nuk kanë filluar apo janë refuzuar, pse kjo laramani, kush e ka përgjegjësinë konkrete në nivel të komunës për këto pagesa dhe menaxhimin e lëndëve të cilat janë dërguar në gjykatë, a ka bashkëpunim të rregullt ndërmjet drejtorive komunale të shëndetësisë, administratës dhe zyrës së financave për ti evidentuar dhe a ekzistojnë këto borxhe, kërkoj sqarim për këto çështje sepse disa nuk kanë përfituar asgjë janë refuzuar , të njëjtë punëtorë të cilët punojnë në komunë ose kanë punuar më herët, disave ju ka refuzuar, disave u janë përgjysmuar shuma e mjeteve financiare, disa kanë përfituar përmes përmbaruesve , dikush ka përfituar përmes vendimeve që janë marr përmes thesarit. A kemi kontratë me kompaninë Pastrimi për pastrimin e rrugëve lokale , nëse dikush ka udhëtuar në rrugën Kashan-Ramuk gati është mbyllur ajo rrugë.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket raporteve financiare besoj që pyetja ke për klubet sportive sepse ne i financojmë të gjitha organizatat joqeveritare të cilat veprojnë në Han të Elezit parashtrorinë kërkesa dhe pastaj bëhet shpërndarja përmes komisioneve dhe ato mjete të cila i kemi i shpërndajmë. Raporte ne nuk bëjmë për klubet por klubet i bëjnë raportet e veta të shpenzimeve të këtyre mjeteve të cilat i kanë marr si subvencione dhe këto duhet që deri në muajin janar të vitit të ardhshëm ti bëjnë raportet për shkak se shpenzimet janë për vitin 2025. Secili raporton për ato mjete të cilat i ka marr se a i ka shpenzuar sipas planifikimeve. Nuk mundet me pasur secili arsimtarë projektorë dhe nuk ka nevojë që secili arsimtarë me marr projektorin me vete. Janë katër tabela digjitale, në secilin kabinet të informatikës në katër shkolla është nga një tabelë digjitale që është përdorur si pilot projekt i tabelave digjitale që unë besoj që javën tjetër do të fillon montimi i këtyre tabelave që për shtatorë të jenë të gatshme që secila klasë ta ketë tabelën digjitale. Sa i përket kontratës kolektive pse do i kanë marr e pse disa jo edhe disa të tjerë kohët e fundit i kanë marr dhe kjo është çështje gjygsore që varësisht gjykata se si i ka përcjell lëndët për shkak se nuk është çështje e jona që me ja përcatur gjykatës se kush me i marr mjetet financiare e kush mos me i marr. Atë unë që dua ta potencojë dhe vullnetin që e kam pas se kontrata kolektive duhet të paguhet dhe kjo ka qenë qëllimi i ndarjes së këtyre mjeteve nga tejkalimi i projeksioneve buxhetore të të hyrave për me i dërguar te kontrata kolektive sepse po duam me hequr si borxh pavarësisht se nuk është borxh i joni por është krejt i dikujt tjetër por ne e kemi marr për sipër dhe me parashtruar kërkesë që këto borxhe dhe të gjitha ata që së paku i kemi dhe shuma që i dimë me i dedikuar mjetet te kontrata kolektive. Çka do që ka borxh nga kontrata kolektive e kam shprehur vullnetin që në fillim që gjitha ato mjete të përlogariten dhe të parashihen dhe aq sa dimë na dhe besoj që në dokumentin që e miratuam më herët janë ato mjete te kontrata kolektive pa asnjë dallim. Shëndetësia e di që i ka marr më herët, te arsimi disa i kanë marr disa janë në pritje edhe në shërbimin civil të komunës dhe stafi politik të cilët nuk i kam ndarë duke u nisur nga ish kryetari dhe drejtorët por kjo varet prej thesarit se kur do ta kenë vullnetin për me implementuar këtë.

Zaim Bela thekson:- po më vjen interesant se të njëjtën punë e kemi bërë si staf politik dhe si staf civil e dikush e merr të përgjysmuar e dikush komplet që do të thotë të njëjtën punë e kanë bërë, a janë bërë laramani prej zyrës ligjore apo prej gjykatës nuk po e di.

Mehmet Ballazhi thekson:- avokatët i shohin hapësirat ligjore dhe i nxjerrin, në fillim të kontratës kolektive e kemi ditur që është diferenca në kualifikim dhe shujtat pastaj dul transporti, inflacioni dhe tash ka kërkesa për kohën e pandemisë. Këto ndarje që duken jo të barabarta që ka dikush e ka barë për shujtë sepse kjo varet te avokatët se si i kanë renditur lëndët për secilin person dhe kur i kanë dërguar në gjykatë atëherë varët prej gjykatës se si i ka proceduar.

Refet Kalisi thekson:- kërkoj nga drejtoria e arsimit që te çerdhja t'i vendos dy klima, njëra të vendoset ë korridor tjetra në kuzhinë për shkak se është temperaturë shumë e madhe.

Hisni Luri thekson:- atëherë kur i kemi vendosur pompat termike i kemi pasur të planifikuara edhe klimat por për shkak mundësive buxhetore nuk kemi mundur me i kryer por në momentin që do të kemi mundësi buxhetore do ti vendosim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/5249/2025

DATA :	14.07.2025
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2025

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar Anëtarë të Kuvendit,

Bazuar në Ligjin nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutit të Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 51.5, gjeni të bashkangjitur raportin financiar për periudhën janar-qershor 2025.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/5249/2025

RAPORTI FINANCIAR JANAR-QERSHOR 2025

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA



Hani i Elezit, Korrik 2025

Përkufizimet

Bilancet - shumat e zotimeve të papritura, ndarjeve buxhetore të pa alokuara, alokimet e pa zotuar dhe çfarëdo të ardhurash të një shume më të madhe se sa shuma e shpenzimeve dhe zotimet e papritura të bartura nga viti fiskal paraprak;

Organizatat Buxhetore – të gjitha Ministrinë, Komunat, Agjencitë dhe Institucionet, të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Kosovës sipas këtij ligji;

Zotimet - shpenzimet e parashikuara, për të cilat urdhëresa për pagesë të zotimit është plotësuar në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit dhe të cilat janë regjistruar në SIMFK, pa marrë parasysh nëse i nënshtrohen apo jo ndonjë detyrimi ligjor;

Kategoritë e shpenzimeve - kategoritë “Pagat dhe Shtesat”, “Mallrat dhe Shërbimet”, “Shërbimet Komunale”, “Subvencionet dhe Transferet”, “Shpenzimet Kapitale” dhe “Rezervat”.

Viti fiskal - periudhën nga 1 Janari i një viti deri 31 dhjetor të vitit të njëjtë;

Alokimi i fondeve – shuma maksimale për zotime dhe shpenzime që mund të bëhet kundrejt ndarjeve specifike buxhetore, siç është përcaktuar me procedurat e parapara në nenin 34 të LMFP-së dhe të regjistruara në SIMFK;

Subvencionet – fondet e siguruar nga shteti për të ndihmuar kompanitë, personat juridik ose sektorët e veçantë të ekonomisë si për shembull bujqësia;

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve KASH– Është një dokument i prioriteteve të politikave të Qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërinë në procesin e buxhetit duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm makroekonomik dhe fiskal (zakonisht në një periudhë 3 vjeçare);

Të hyrat vetanake të komunave - çfarëdo e hyre e parasë publike e cila është vlerësuar dhe mbledhur nga komunat nga burimet e specifikuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108;

Burimet e financimit – grantet qeveritare (GQ), të hyrat vetanake (THV), të hyrat e dedikuara (THD), të hyrat nga AKP-ja dhe financimet nga huamarrja brenda deficitit buxhetor (FH);

Transferet - Çdo ndryshim i ndodhur brenda ndarjeve të aprovuara të paraqitura në tabelat 3.1, 3.1A, 3.1 B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2 nënkupton transferet që janë:

- ndryshimi i shumave të ndara në mes të organizatave buxhetore,
- ndryshimet që ndodhin mes nën-programeve të po të njëjtës organizatë buxhetore dhe
- ndryshimet e ndodhura mes secilës kategori të shpenzimeve të paraqitur në tabelën 3.1,3.1A, 3.1B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2.

Rialokimet - Çdo ndryshim i ndodhur në tabelën 3.2, 3.2B; dhe 4.2 në kategorinë e shpenzimeve kapitale brenda një nën-programi të një organizate buxhetore;

HYRJJE

Raporti financiar për periudhën janar - qershor 2025, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5.

Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës gjashtë mujore të vitit aktual 2025. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore.

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program Buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së Përgjithshme, Shëndetësisë Primare, Arsimit dhe Shkenca për periudhën Janar – Qershor 2025, duke përfshirë kategoritë buxhetore të pagave dhe shtesave, mallrat dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencionet dhe transferet si dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave vetanake komunale dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyrë analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Qershor të vitit 2025/2024.

Buxheti i Komunës për vitin 2025, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2025, për komunën Hani i Elezit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Një pasqyrë për të gjitha kategoritë buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet si dhe investimet kapitale,
- Mundësinë e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive,
- Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për gjithë kategoritë buxhetore si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

1. BUXHETI KOMUNAL 2025

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me **NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025** është në lartësi prej **3,615,457.00 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 2,188,542.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 584,500.00 €,
- Shpenzimet komunale94,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere... 143,000.00 €,
- Shpenzime kapitale 605,415.00 €,
- **Totali i buxhetit..... 3,615,457.00 €.**

1.1 NDARJET FILLESTARE DHE FINALE BUXHETORE 2025

Kategoritë ekonomike	Ndarjet Buxhetore Nr: 08/L-332	49 - BE - Bashkimi Evropian	Grante të mbetur a	59 - Qeveria Japoneze	22 - Të hyrat e bartura	Shtesa	Total
Paga dhe shtesa	2,188,542.00					94,611.84	2,283,153.84
Mallra dhe shërbime	584,500.00	68,346.08	0.50	800.00	15,860.96		669,507.54
Shpenzime Komunale	94,000.00						94,000.00
Subvencione dhe transfere	143,000.00	-			5,000.00		148,000.00
Shpenzime Kapitale	605,415.00	107,789.37	113.18	15,123.01	149,910.71		878,351.27
Total	3,615,457.00	176,135.45	113.68	15,923.01	170,771.67	94,611.84	4,073,012.65

Ndërsa buxheti përfundimtar siç mund ta shohim në tabelën më lartë është **4,073,012.65 €**, ku në këtë shumë përfshihen:

1. Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej **3,275,738.00 €**,
2. Projektioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej **339,719.00 €**,
3. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024, në shumë prej **170,771.67 €**,
4. Mjetet e mbetura nga Donacioni i Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej **15,923.01 €**,
5. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej **176,135.45 €**,
6. Shtesë në kategorinë buxhetore Paga dhe Shtesa, në shumë prej **94,611.84 €**,
7. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej **113.68 €**.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - qershor 2025 është në shumë prej **1,758,538.44 €**.

2. TË HYRAT VETANAKE

2.1 Të Hyrat Vetanake Komunale të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2025/2024


Përshkrimi	Projeksioni i të hyrave vetanake 2025	Realizimi Janar-Qershor 2025	Realizimi Janar-Qershor 2024	Ndryshimi 2025-2024	Krahasimi 2025/2024
Të hyrat direkte	339,719	1,073,084.60	162,316.72	910,767.88	561.06 %

SQARIM:

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, komuna Hani i Elezit ka realizuar të hyra vetanake direkte në shumë prej 1,073,084.60 €, që përfaqëson një rritje të konsiderueshme prej 561.06 % apo rritje në shumëfish prej 6.61 herë më shumë, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2024, kur është inkasuar vetëm 162,316.72 €.

Kjo rritje kalon bindshëm edhe projeksionin e vitit aktual 2025 (339,719 €) dhe mund t'i atribuohet përmirësimit të efikasitetit në inkasimin e të hyrave.

Vlen të theksohet se në këtë tabelë nuk i kemi paraqitur të hyrat indirekte të TM2.



2.2 Krahاسimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike Janar-Qershor 2025/2024

Nr	Kodi	Përshkrimi	Realizimi Janar-Qershor 2025	Realizimi Janar-Qershor 2024	Krahاسimi në euro 2025-2024
1	50000	Të hyrat në pritje për shpërndarje	-	160.00	(160.00)
2	50013	Certifikatat e lindjes	37.50	149.00	(111.50)
3	50014	Certifikatat e kurorëzimit	50.00	210.00	(160.00)
4	50015	Certifikatat e vdekjes	6.00	10.00	(4.00)
5	50016	Taksa për çertifikata tjera	1,059.00	2,039.00	(980.00)
6	50017	Taksa për verifikimin e dok. të ndryshme	13.00	10.00	3.00
7	50019	Taksa tjera administrative	301.00	147.00	154.00
I	163	Administrata e Përgjithshme	1,466.50	2,725.00	(1,258.50)
8	40110	Tatimi në pronë dhe në tokë	50,529.20	44,303.94	6,225.26
9	50001	Taksë për regjistrim të automjeteve	11,730.00	10,710.00	1,020.00
II	175	Buxhet dhe Financa	62,259.20	55,013.94	7,245.26
10	50019	Taksa të tjera administrative	1,267.05	1,686.05	(419.00)
11	50029	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	665.00	-	665.00
12	50208	Licenca për transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave		265.00	(265.00)
13	50212	Licenca për reklama dhe publikime në prona publike	2,279.70	1,769.70	510.00
14	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	1,860.00	-	1,860.00
15	50107	Gjobat tjera	1,574.90	-	1,574.90
III	180	Shërbimet Publike	7,646.65	3,720.75	3,925.90
16	50012	Ndërrim destinimi i tokës	-	-	-
17	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	-	-	-
18	50107	Gjoba tjera	-	-	-
IV	470	Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	-	-	-
19	50029	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	73,439.80	74,377.88	(938.08)
20	50104	Gjoba nga Inspektoriati			-
21	50205	Licenca për pranim teknik të lokalit	20.00	10.00	10.00
V	480	Zhvillimi Ekonomik	73,459.80	74,387.88	(928.08)
22	50009	Taksa komunale për leje ndërtimi	112.07	5,887.75	(5,775.68)
23	50011	Taksë për ndërrim të pronarit të pronës	1,990.00	2,480.00	(490.00)
24	50026	Taksë për legalizim të objekteve	635.36	306.09	329.27
25	50012	Taksa për ndërrim të destinimit të pronës	908,571.71	-	908,571.71
26	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	927.36	869.16	58.20
27	50019	Taksa tjera administrative	2,150.00	5,129.00	(2,979.00)
VI	660	Urbanizimi dhe Kadastri	914,386.50	14,672.00	899,714.50
28	50409	Participimet në Arsim	8,500.00	7,740.00	760.00
VII	920	Arsimi	8,500.00	7,740.00	760.00

29	50019	Taksa për shërbimet sociale	147.00	26.00	121.00
30	50409	Participimet në shëndetësi	4,018.95	3,936.15	82.80
31	50024	Taksa për çertifikata mjekësore	1,035.00		1,035.00
VIII	730	Shëndetësia dhe MS	5,200.95	3,962.15	1,238.80
32	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	165.00	95.00	70.00
IX	850	Kulturë, Rini dhe Sport	165.00	95.00	70.00
A		TË HYRAT DIREKTE	1,073,084.60	162,316.72	910,767.88
33	50101	Të hyrat nga dënimet në trafik	46,460.00	13,360.00	33,100.00
34		Të hyrat nga Agjensioni Pyjor	198.75	2,122.56	(1,923.81)
35	50102	Të hyrat nga dënimet në gjykata		-	-
B		TË HYRAT INDIREKTE	46,658.75	15,482.56	(31,176.19)
		TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)	1,119,743.35	177,799.28	941,944.07

3. RAPORTI I KONTROLLIT BUXHETOR JANAR-QERSHOR 2025 NGA SIMFK

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Alokuar	E paalokuar	Aktuali	Zotimet/obligi met e papaguara	Bilanci	Suficit/Deficit
CAT / RESP / GPC / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	A - E
10 BUXHETI	3,370,349.84	2,217,548.09	1,152,801.75	1,555,100.19	61,524.97	1,753,724.68	3,370,349.84
659 HANI I ELEZIT	3,370,349.84	2,217,548.09	1,152,801.75	1,555,100.19	61,524.97	1,753,724.68	3,370,349.84
160 KRYETARI ASAMBLEJA KOMUNALE	164,822.36	108,473.29	56,349.07	93,606.81	545.00	70,670.55	164,822.36
11 PAGA DHE SHTESA	114,822.36	58,473.29	56,349.07	58,473.29	0.00	56,349.07	114,822.36
13 MALLRA DHE SHËRBIME	50,000.00	50,000.00	0.00	35,133.52	545.00	14,321.48	50,000.00
163 ADMINISTRATA DHE PERSONELI	236,671.83	183,715.91	52,955.92	130,596.60	7,148.01	98,927.22	236,671.83
11 PAGA DHE SHTESA	106,671.83	53,715.91	52,955.92	53,715.91	0.00	52,955.92	106,671.83
13 MALLRA DHE SHËRBIME	75,000.00	75,000.00	0.00	52,972.28	7,014.85	15,012.87	75,000.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	55,000.00	55,000.00	0.00	23,908.41	133.16	30,958.43	55,000.00
169 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	137,002.29	86,991.09	50,011.20	72,630.49	0.00	64,371.80	137,002.29
11 PAGA DHE SHTESA	119,502.29	69,491.09	50,011.20	69,491.09	0.00	50,011.20	119,502.29
13 MALLRA DHE SHËRBIME	17,500.00	17,500.00	0.00	3,139.40	0.00	14,360.60	17,500.00
175 BUXHET,FINANCA	73,661.93	33,058.64	40,603.29	33,043.58	0.00	40,618.35	73,661.93
11 PAGA DHE SHTESA	70,161.93	29,558.64	40,603.29	29,543.58	0.00	40,618.35	70,161.93
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,500.00	3,500.00	0.00	3,500.00	0.00	0.00	3,500.00
180 SHERB.PUBLI.MBROJT.CIVIL.EMER	223,745.88	174,586.56	49,159.32	112,321.27	270.13	111,154.48	223,745.88
11 PAGA DHE SHTESA	95,745.88	46,586.56	49,159.32	46,586.56	0.00	49,159.32	95,745.88
13 MALLRA DHE SHËRBIME	100,000.00	100,000.00	0.00	59,829.91	270.13	39,899.96	100,000.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	3,000.00	3,000.00	0.00	904.80	0.00	2,095.20	3,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	25,000.00	25,000.00	0.00	5,000.00	0.00	20,000.00	25,000.00
195 ZYRA E KOMUNITETEVE	3,900.00	1,350.00	2,550.00	0.00	0.00	3,900.00	3,900.00
11 PAGA DHE SHTESA	3,400.00	850.00	2,550.00	0.00	0.00	3,400.00	3,400.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	0.00	0.00	500.00	500.00
470 BUJQESI PYLLTAR.ZHVILL.RURAL	13,789.49	7,996.40	5,793.09	5,996.40	0.00	7,793.09	13,789.49
11 PAGA DHE SHTESA	11,789.49	5,996.40	5,793.09	5,996.40	0.00	5,793.09	11,789.49
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,000.00	2,000.00	0.00	0.00	0.00	2,000.00	2,000.00
480 ZHVILLIMI EKONOMIK	92,739.46	78,712.98	14,026.48	18,234.86	41,814.05	32,690.55	92,739.46
11 PAGA DHE SHTESA	28,739.46	14,712.98	14,026.48	14,712.98	0.00	14,026.48	28,739.46
13 MALLRA DHE SHËRBIME	9,000.00	9,000.00	0.00	3,521.88	978.75	4,499.37	9,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	55,000.00	55,000.00	0.00	0.00	40,835.30	14,164.70	55,000.00
660 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	393,279.90	356,331.88	36,948.02	63,097.33	0.00	330,182.57	393,279.90
11 PAGA DHE SHTESA	74,883.90	37,935.88	36,948.02	37,935.88	0.00	36,948.02	74,883.90
13 MALLRA DHE SHËRBIME	35,000.00	35,000.00	0.00	1,584.00	0.00	33,416.00	35,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	283,396.00	283,396.00	0.00	23,577.45	0.00	259,818.55	283,396.00

RAPORTI FINANCIAR JANAR-QERSHOR 2025

730 KUJDESI PRIMAR SHENDETESOR	435,908.09	255,589.52	180,318.57	239,737.28	4,586.60	191,584.21	435,908.09
11 PAGA DHE SHTESA	348,408.09	168,089.52	180,318.57	166,130.89	0.00	182,277.20	348,408.09
13 MALLRA DHE SHËRBIME	70,500.00	70,500.00	0.00	65,818.14	2,974.83	1,707.03	70,500.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	12,000.00	12,000.00	0.00	7,788.25	1,611.77	2,599.98	12,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,000.00	5,000.00	0.00	0.00	0.00	5,000.00	5,000.00
755 SHERBIMET SOCIALE REZIDENCIALE	29,502.46	17,333.12	12,169.34	13,945.81	0.00	15,556.65	29,502.46
11 PAGA DHE SHTESA	25,702.46	13,533.12	12,169.34	13,327.16	0.00	12,375.30	25,702.46
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,800.00	2,800.00	0.00	271.60	0.00	2,528.40	2,800.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	1,000.00	1,000.00	0.00	347.05	0.00	652.95	1,000.00
850 KULTURË, RINI, SPORT	60,580.95	45,061.89	15,519.06	24,061.89	2,965.00	33,554.06	60,580.95
11 PAGA DHE SHTESA	32,080.95	16,561.89	15,519.06	16,561.89	0.00	15,519.06	32,080.95
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	0.00	2,000.00	2,965.00	10,035.00	15,000.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	5,500.00	5,500.00	0.00	5,500.00	0.00	0.00	5,500.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	8,000.00	8,000.00	0.00	0.00	0.00	8,000.00	8,000.00
920 ARSIM DHE SHKENCË	1,504,745.20	868,346.81	636,398.39	747,827.87	4,196.18	752,721.15	1,504,745.20
11 PAGA DHE SHTESA	1,251,245.20	614,846.81	636,398.39	614,401.07	0.00	636,844.13	1,251,245.20
13 MALLRA DHE SHËRBIME	148,000.00	148,000.00	0.00	50,995.46	2,433.91	94,570.63	148,000.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	17,500.00	17,500.00	0.00	8,038.35	1,762.27	7,699.38	17,500.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	88,000.00	88,000.00	0.00	74,392.99	0.00	13,607.01	88,000.00
21 TË HYRAT VETANAKE	339,719.00	339,719.00	0.00	123,381.48	75.53	216,261.99	339,719.00
659 HANI I ELEZIT	339,719.00	339,719.00	0.00	123,381.48	75.53	216,261.99	339,719.00
160 KRYETARI ASAMBLEJA KOMUNALE	40,000.00	40,000.00	0.00	24,650.00	0.00	15,350.00	40,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	40,000.00	40,000.00	0.00	24,650.00	0.00	15,350.00	40,000.00
163 ADMINISTRATA DHE PERSONELI	15,000.00	15,000.00	0.00	0.00	0.00	15,000.00	15,000.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	0.00	0.00	0.00	15,000.00	15,000.00
180 SHERB.PUBLI.MBROJT.CIVIL.EMER	56,915.00	56,915.00	0.00	15,296.86	75.47	41,542.67	56,915.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	20,000.00	20,000.00	0.00	10,296.86	75.47	9,627.67	20,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	13,000.00	13,000.00	0.00	5,000.00	0.00	8,000.00	13,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	23,915.00	23,915.00	0.00	0.00	0.00	23,915.00	23,915.00
470 BUJQESI PYLLTAR.ZHVILL.RURAL	27,000.00	27,000.00	0.00	14,927.08	0.00	12,072.92	27,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	27,000.00	27,000.00	0.00	14,927.08	0.00	12,072.92	27,000.00
480 ZHVILLIMI EKONOMIK	15,500.00	15,500.00	0.00	14,997.60	0.00	502.40	15,500.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	0.00	0.00	500.00	500.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	15,000.00	15,000.00	0.00	14,997.60	0.00	2.40	15,000.00
660 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	93,604.00	93,604.00	0.00	0.00	0.00	93,604.00	93,604.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	0.00	0.00	5,000.00	5,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	88,604.00	88,604.00	0.00	0.00	0.00	88,604.00	88,604.00
730 KUJDESI PRIMAR SHENDETESOR	5,000.00	5,000.00	0.00	2,999.94	0.06	2,000.00	5,000.00

RAPORTI FINANCIAR JANAR-QERSHOR 2025

13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	2,999.94	0.06	2,000.00	5,000.00
755 SHERBIMET SOCIALE REZIDENCIALE	200.00	200.00	0.00	0.00	0.00	200.00	200.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	200.00	200.00	0.00	0.00	0.00	200.00	200.00
850 KULTURË,RINI,SPORT	26,000.00	26,000.00	0.00	17,000.00	0.00	9,000.00	26,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	18,000.00	18,000.00	0.00	17,000.00	0.00	1,000.00	18,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	8,000.00	8,000.00	0.00	0.00	0.00	8,000.00	8,000.00
920 ARSIM DHE SHKENCË	60,500.00	60,500.00	0.00	33,510.00	0.00	26,990.00	60,500.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	10,000.00	10,000.00	0.00	0.00	0.00	10,000.00	10,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	30,000.00	30,000.00	0.00	29,900.00	0.00	100.00	30,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	20,500.00	20,500.00	0.00	3,610.00	0.00	16,890.00	20,500.00
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	170,771.67	170,771.67	0.00	250.00	0.00	170,521.67	170,771.67
659 HANI I ELEZIT	170,771.67	170,771.67	0.00	250.00	0.00	170,521.67	170,771.67
175 BUXHET,FINANCA	2,000.00	2,000.00	0.00	250.00	0.00	1,750.00	2,000.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,000.00	2,000.00	0.00	250.00	0.00	1,750.00	2,000.00
180 SHERB.PUBLI.MBROJT.CIVIL. EMER	5,860.96	5,860.96	0.00	0.00	0.00	5,860.96	5,860.96
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,860.96	5,860.96	0.00	0.00	0.00	5,860.96	5,860.96
660 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	88,771.67	88,771.67	0.00	0.00	0.00	88,771.67	88,771.67
30 PASURITË JOFINANCIARE	88,771.67	88,771.67	0.00	0.00	0.00	88,771.67	88,771.67
730 KUJDESI PRIMAR SHENDETESOR	6,139.04	6,139.04	0.00	0.00	0.00	6,139.04	6,139.04
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	0.00	0.00	5,000.00	5,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	1,139.04	1,139.04	0.00	0.00	0.00	1,139.04	1,139.04
920 ARSIM DHE SHKENCË	68,000.00	68,000.00	0.00	0.00	0.00	68,000.00	68,000.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	3,000.00	0.00	0.00	0.00	3,000.00	3,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	5,000.00	5,000.00	0.00	0.00	0.00	5,000.00	5,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	60,000.00	60,000.00	0.00	0.00	0.00	60,000.00	60,000.00
32 GRANTE TJERA TË JASHTME	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
659 HANI I ELEZIT	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
660 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
49 BE - BASHKIMI EUROPIAN	176,135.45	176,135.45	0.00	71,830.82	19,016.73	85,287.90	176,135.45
659 HANI I ELEZIT	176,135.45	176,135.45	0.00	71,830.82	19,016.73	85,287.90	176,135.45
660 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	176,135.45	176,135.45	0.00	71,830.82	19,016.73	85,287.90	176,135.45
13 MALLRA DHE SHËRBIME	68,346.08	68,346.08	0.00	12,748.32	2,096.73	53,501.03	68,346.08
30 PASURITË JOFINANCIARE	107,789.37	107,789.37	0.00	59,082.50	16,920.00	31,786.87	107,789.37
59 QEVERIA JAPONEZE	15,923.01	15,923.01	0.00	7,975.95	0.00	7,947.06	15,923.01
659 HANI I ELEZIT	15,923.01	15,923.01	0.00	7,975.95	0.00	7,947.06	15,923.01
660 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	15,923.01	15,923.01	0.00	7,975.95	0.00	7,947.06	15,923.01
13 MALLRA DHE SHËRBIME	800.00	800.00	0.00	0.00	0.00	800.00	800.00

RAPORTI FINANCIAR JANAR-QERSHOR 2025

30 PASURITË JOFINANCIARE	15,123.01	15,123.01	0.00	7,975.95	0.00	7,147.06	15,123.01
60 UN-HABITAT	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.26
659 HANI I ELEZIT	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.26
660 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.26
30 PASURITË JOFINANCIARE	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.26
61 QEVERIA ZVICRANE	83.42	83.42	0.00	0.00	0.00	83.42	83.42
659 HANI I ELEZIT	83.42	83.42	0.00	0.00	0.00	83.42	83.42
163 ADMINISTRATA DHE PERSONELI	0.50	0.50	0.00	0.00	0.00	0.50	0.50
13 MALLRA DHE SHËRBIME	0.50	0.50	0.00	0.00	0.00	0.50	0.50
660 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	62.60	62.60	0.00	0.00	0.00	62.60	62.60
30 PASURITË JOFINANCIARE	62.60	62.60	0.00	0.00	0.00	62.60	62.60
920 ARSIM DHE SHKENCË	20.32	20.32	0.00	0.00	0.00	20.32	20.32
30 PASURITË JOFINANCIARE	20.32	20.32	0.00	0.00	0.00	20.32	20.32
Totali i përgjithshëm	4,073,012.65	2,920,210.90	1,152,801.75	1,758,538.44	80,617.23	2,233,856.98	4,073,012.65

3.1 PËRQINDJA E REALIZIMIT DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN RAPORTUESE JANAR – QERSHOR 2025 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2024

Kategoritë buxhetore	Buxheti 2025	Buxheti i alokuar	Realizimi Janar-Qershor 2025	% Realizim/alokim	% Realizim/planifikim
Paga dhe shitesa	2,188,542.00	1,130,352.09	1,126,876.70	99.69%	51.49%
Mallra dhe shërbime	584,500.00	669,507.54	305,061.31	45.57%	52.19%
Shpenzime komunale	94,000.00	94,000.00	46,486.86	49.45%	49.45%
Subvencione dhe trans.	143,000.00	148,000.00	106,474.68	71.94%	74.46%
Investime Kapitale	605,415.00	878,351.27	173,638.89	19.77%	28.68%
TOTAL	3,615,457.00	2,920,210.90	1,758,538.44	60.22%	48.64%

Kategoritë buxhetore	Buxheti i alokuar	Realizimi Janar-Qershor 2024	% Realizim/alokim	% Realizim/planifikim	Krahasimi në euro 2025/24	Krahasimi në % 2025/24
Paga dhe shitesa	2,153,367.87	1,119,864.18	52.01%	53.96%	7,012.52	0.63
Mallra dhe shërbime	525,307.51	224,946.14	42.82%	42.89%	80,115.17	35.62
Shpenzime komunale	93,500.00	39,028.55	41.74%	41.74%	7,458.31	19.11
Subvencione dhe trans.	113,000.00	74,421.00	65.86%	65.86%	32,053.68	43.07
Investime Kapitale	926,499.04	76,061.30	8.21%	14.01%	97,577.59	128.29
TOTAL	3,811,674.42	1,534,321.17	40.25%	45.81%	224,217.27	14.61


SOARIM:

- Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë prej 1,126,876.70 € apo 99.69% nga Buxheti i alokuar dhe 51.49% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë periudhës raportuese të vitit 2025 është më i lartë për 7,012.52 € apo 0.63 % më shumë.
- Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë 305,061.31 € apo 45.57% nga Buxheti i alokuar dhe 52.19% nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë tremujorit të vitit 2025 është më i lartë për 80,115.17 € apo 35.62 % më shumë.
- Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Komunale për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë prej 46,486.86 € apo 49.45% nga Buxheti i alokuar dhe 49.45% nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2025 është më i lartë për 7,458.31 € apo 19.11 % më shumë.
- Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë prej 106,474.68 € apo 71.94 % nga Buxheti i alokuar dhe 74.46 % nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2025 është më i lartë për 32,053.68 € apo 43.07 % më shumë.
- Nga kategoria buxhetore Shpenzime Kapitale, për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë prej 173,638.89 € apo 19.77% nga buxheti i alokuar dhe 28.68% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2025 është më i lartë për 97,577.59 € apo 128.29 % më shumë.

Shpenzueshmëria totale e Buxhetit të alokuar për periudhën raportuese Janar-Qershor 2025, duke i përfshirë të gjithë kategoritë buxhetore është në shumë prej 1,758,538.44 € apo 60.2%.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2024, shpenzimi total është 1,534,321.17 € apo 224,217.27 € më pak se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.

3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike



3.3 EKZEKUTIMI I BUXHETIT JANAR-QERSHOR 2025 SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

<i>Programet (Drejtoritë)</i>	<i>Pagat dhe shtesat</i>	<i>Mallrat dhe shërbimet</i>	<i>Shpenzimet komunale</i>	<i>Subvencionet dhe transferet</i>	<i>Shpenzimet kapitalet</i>	<i>Totali i shpenzimeve</i>
Totali	1,126,876.70	305,061.31	46,486.86	106,474.68	114,556.39	1,699,455.94
GRANTI QEVERTAR (10)	1,126,876.70	278,766.19	46,486.86	-	102,970.44	1,555,100.19
<i>Zyra e Kryetarit</i>	58,473.29	35,133.52	-	-	-	93,606.81
<i>Administrata e Përgjithshme</i>	53,715.91	52,972.28	23,908.41	-	-	130,596.60
<i>Zyra e Kuvendit Komunal</i>	69,491.09	3,139.40	-	-	-	72,630.49
<i>Buxhet dhe Financa</i>	29,543.58	3,500.00	-	-	-	33,043.58
<i>Shërbime Publike dhe Emergjencia</i>	46,586.56	59,829.91	904.80	-	5,000.00	112,321.27
<i>Zyra lokale për Komunitete</i>	-	-	-	-	-	-
<i>Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural</i>	5,996.40	-	-	-	-	5,996.40
<i>Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi</i>	14,712.98	3,521.88	-	-	-	18,234.86
<i>Urbanizmi</i>	37,935.88	1,584.00	-	-	23,577.45	63,097.33
<i>Shërbimet e Shëndetësisë Primare</i>	166,130.89	65,818.14	7,788.25	-	-	239,737.28
<i>Shërbimet sociale</i>	13,327.16	271.60	347.05	-	-	13,945.81
<i>Shërbime Kulturore</i>	16,561.89	2,000.00	5,500.00	-	-	24,061.89
<i>Arsim dhe Shkencë</i>	614,401.07	50,995.46	8,038.35	-	74,392.99	747,827.87
TË HYRAT VETANAKE-21	-	13,296.80	-	106,474.68	3,610.00	123,381.48
<i>Zyra e Kryetarit</i>	-	-	-	24,650.00	-	24,650.00
<i>Shërbime Publike dhe Emergjencia</i>	-	10,296.86	-	5,000.00	-	15,296.86
<i>Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi</i>	-	-	-	14,997.60	-	14,997.60
<i>Bujqësia</i>	-	-	-	14,927.08	-	14,927.08
<i>Shërbimet e Shëndetësisë Primare</i>	-	2,999.94	-	-	-	2,999.94
<i>Kulturë, Rini dhe Sport</i>	-	-	-	17,000.00	-	17,000.00
<i>Arsim dhe Shkencë</i>	-	-	-	29,900.00	3,610.00	33,510.00
TË HYRAT E BARTUARA - 22	-	250.00	-	-	-	250.00
<i>Buxhet dhe Financa</i>	-	250.00	-	-	-	250.00
49 BE - BASHKIMI EUROPIAN	-	12,748.32	-	-	-	12,748.32
<i>Urbanizmi</i>	-	12,748.32	-	-	-	12,748.32
59 QEVERIA JAPONEZE	-	-	-	-	7,975.95	7,975.95
<i>Urbanizmi</i>	-	-	-	-	7,975.95	7,975.95

3.4 KATEGORIA PAGA DHE SHTESA SIPAS KODEVE EKONOMIKE

Kodi	Përshkrimi	Shpenzimi Janar-Qershor 2025	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Krahasimi 2025-2024	Krahasimi në %
1	Paga dhe shtesa				
1111	Pagat neto	888,028.44	793,061.84	94,966.60	11.97
1121	Tatimi në të ardhura personale	58,415.34	58,028.63	386.71	0.67
1131	Kontributi pensional - Punëtori	53,180.76	47,339.02	5,841.74	12.34
1121	Përvoja e punës	42,555.90	35,220.56	7,335.34	20.83
1131	Kontributi pensional - Punëdhënësi	53,180.76	47,339.02	5,841.74	12.34
1141	Shtesa e veçantë për të zgjedhurit	11,574.01	11,148.83	425.18	3.81
11416	Shtesa për vëllimin e punës	1,492.99	-	1,492.99	#DIV/0!
11151	Sindikatat	1,943.49	1,655.91	287.58	17.37
11152	Odat profesionale	970.62	918.18	52.44	5.71
11431	Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës	15,534.39	10,267.11	5,267.28	51.30
11900	Pagesa për vendime gjyqësore	-	114,885.08	-114,885.08	-100.00
	Totali për paga dhe shtesa	1,126,876.70	1,119,864.18	7,012.52	0.63

SQARIM:

1111 – Paga neto– Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 888,028.44 €. Këtu përfshihen të gjithë pagat e rregullta neto për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

1121 - Tatimi i ndalur në të ardhurat personale - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 58,415.34 €. Këtu përfshihen të gjithë pagesat e tatimeve për të ardhurat personale për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

1131- Kontributi pensional - Punëtori - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 53,180.76 €. Këtu përfshihen 5% nga punëmarrësi e pagesës së kontributeve për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

11211 – Përvoja e punës - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 42,555.90 €. Këtu përfshihet pagesa e përvojës së punës nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

11311 - Kontributi pensional – Punëdhënësi - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 53,180.76 €. Këtu përfshihen 5% nga punëdhënësi e pagesës së kontributeve për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

11411 – Shtesa e veçantë për të zgjedhurit - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 11,574.01 €. Këtu përfshihen shtesat që ju takojnë Asamblesë Komunale.

11416 – Shtesa për vëllimin e punës - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 1,492.99 €. Këtu përfshihen pagesat e disa Marrëveshjeve për vëllimin e shtuar të punës të shërbyesve civil.

11151 – Sindikatat - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 1,943.49 €, në të cilën përfshihen pagesat për Sindikatë në Sektorin e Arsimit dhe Shëndetësisë.

11152 – Odat Profesionale - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 970.62 € në Sektorin e Shëndetësisë.

11431 – Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2025 është 15,534.39 € në Sektorin e Shëndetësisë, Sektorin e Arsimit, Shërbimi Social dhe punët e zhvilluara jashtë orarit të punës nga shërbimi civil.

3.5 KATEGORIA MALLRA DHE SHËRBIME SIPAS KODEVE EKONOMIKE

2	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimi Janar- Qershor 2025	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Krahasimi 2025-2024	Krahasimi në %
13130	Transporti i udhëtimit zyrtar brenda vendit	14,622.40	13,366.50	1,255.90	9.40
13140	Transporti i udhëtimit zyrtar jashtë vendit	346.00	0.00	346.00	#DIV/0!
13310	Interneti	1,114.00	1473.3	-359.30	- 24.39
13320	Telefonia mobile	6,816.60	6,875.80	-59.20	- 0.86
13330	Shpenzimet postare	164.10	650.19	-486.09	- 74.76
13141	Para xhepi - Mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit	1,266.40	778.4	488.00	62.69
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	6,790.00	4,000.00	2,790.00	69.75
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	40,000.00	16,173.88	23,826.12	147.31
13440	Shërbime të ndryshme këshilldhënëse dhe profesionale	15,470.16	1035.1	14,435.06	1,394.56
13445	Shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual	250.00	285.1	-35.10	- 12.31
13450	Shërbimet e shtypjes/printimit	-	300	-300.00	- 100.00
13460	Shërbime kontraktuese tjera	4,157.12	14,428.79	-10,271.67	- 71.19
13470	Shërbime teknike	6,354.04	4,749.22	1,604.82	33.79
13480	Shpenzimet për anëtarësim	2,400.45	2,400.45	0.00	-
13501	Mobiljet	2,394.00	-	2,394.00	#DIV/0!
13503	Kompjuter (më pak se 1000 euro)	-	595	-595.00	-100.00
13505	Makina fotokopjuese multifunksionale	-	2781	-2,781.00	- 100.00
13509	Pajisje tjera	1,198.00	2834	-1,636.00	-57.73
13610	Furnizim për zyrë	7,373.35	10,136.82	-2,763.47	-27.26
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	15,694.36	12,822.75	2,871.61	22.39
13630	Furnizime mjekësore	6,186.00	13,381.66	-7,195.66	- 53.77
13640	Furnizime pastrimi	6,082.14	5,790.35	291.79	5.04
13760	Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	1,940.00	-	1,940.00	#DIV/0!
13780	Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri	10,832.52	13,639.74	-2,807.22	- 20.58
13810	Avancë (Paradhënia) për para të imëta	500.00	1000	-500.00	-50.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	555.00	610	-55.00	-9.02
13951	Sigurimi i automjeteve	4,002.71	1837.57	2,165.14	117.83
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	4,859.50	3,805.50	1,054.00	27.70
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	773.00	6,131.20	-5,358.20	- 87.39
14023	Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	12,565.00	12,455.35	109.65	0.88
14024	Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	2,020.00	2277	-257.00	- 11.29
14030	Mirëmbajtja e autorrugëve	5,950.57		5,950.57	#DIV/0!
14032	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	51,747.40	49,107.98	2,639.42	5.37

14050	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	-	500.00	-500.00	-100.00
14160	Qiraja për automjete	-	205.81	-205.81	-100.00
14220	Botimet e publikimeve	-	495	-495.00	- 100.00
14310	Kompenismi i përfaqësimit brenda vendit	22,044.93	8,266.61	13,778.32	166.67
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	34,837.48	9,756.07	25,081.41	257.09
14420	Vendimet Administrative - Neni 39.2 LMFP	13,754.08	0.00	13,754.08	#DIV/0!
	Totali për mallra dhe shërbime	305,061.31	224,946.14	80,115.17	35.62

SQARIM:

13130 - Transporti i udhëtimit zyrtar brenda vendit – Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 ka arritur në vlerë prej 14,622.40 €, për transportin e nxënësve për këto destinacione Krivenik – Hani i Elezit dhe anasjelltas, Kashan - Hani i Elezit dhe anasjelltas, Gorancë – Hani Elezit dhe anasjelltas si dhe Kaçanik – Hani i Elezit dhe anasjelltas.

13140 - Transporti i udhëtimit zyrtar jashtë vendit - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 ka arritur në vlerë prej 346.00 €, ka të bëjë me pagesën e dy biletave për udhëtim zyrtar në Angli.

13310 –Interneti – Shpenzimi për këtë kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e internetit në vlerë prej 1,114.00 € për nevojat e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

13320 –Telefonia mobile - Shpenzimi për këtë kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e telefonisë mobile në vlerë prej 10,399.35 € për nevojat e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

13330 – Shpenzime postare - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 ka të bëjë me pagesën e shërbimeve postare në vlerë prej 164.10 €.

13141 – Para xhepi – Mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 është në shumë prej 1,266.40 € dhe ka të bëjë me pagesën e një mëditje për udhëtim zyrtar në Bosnje me temë “Women in cybersecurity, empowerment and career transition event”, mëditje për udhëtim zyrtar në Shqipëri – Pritja zyrtare në Pallatin e Brigadave, dy mëditje për udhëtim zyrtar në Angli lidhur me temën “Simpoziumi kombëtar i paqes” të organizuar nga Shoqata Muslimane, një mëditje për udhëtim zyrtar në Bullgari, me temë “Zbatimi i ligjit në nivel lokal” të organizuar nga OSBE, një mëditje për udhëtim zyrtar në Shqipëri me temë, “Menaxhimi i integruar i mbeturinave” i organizuar nga GIZZ-i, mëditje për udhëtim zyrtar

në Suedi, me temë “Financat komunale dhe grantet bazë të performancës”, mëditje për udhëtim zyrtar në Shkup, Maqedoni Veriore, tema, “Bashkpunimi ndërkufitar për ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme”.

13410 – Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshin: pagesën prej 3,000.00 € për Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim – Toka, pagesa prej 2,790.00 € për APPK, pagesa prej 1,000.00 € për Shoqatën Profesionale të Informaticientëve të Kosovës.

13430 – Shërbime të ndryshme shëndetësore - pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshin pagesën prej 40,000.00 € për Marrëveshjen e Bashkinancimit të OB-së me Islamic Relief Kosova, me staf shëndetësor.

13440 – Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshin: pagesën e anëtarit të Komitetit për Komunitet, pagesa e 4 Administratorëve, pagesa e dy zyrtarëve nga Komuna e Kaçanikut për shërbimet e kryera për Komunën tonë (Menaxhimi i Planit të Cash-it dhe certifikimi i lëndëve).

13445 – Shërbimet e veçanta – konsulentë dhe kontraktorë individual - pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshin pagesën prej 250.00€ për ekspertizën e Aktvendimit me nr CN nr.200/2017.

13460 – Shërbime Kontraktuese tjera – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshijnë: riparimi i shportave, ngjyrosje të ulseve të parqeve, salldim i shenjave, furnizim me mbajtëse të flamujve, salldimi i grilave metalike, pagesa e hartimit të projektit “Rregullimi i deponisë së mbeturinave të ngurta në Gorancë”, pagesa e shfaqes teatrale për Shtëpinë Filmike “Dielli”.

13470 – Shërbime Teknike - pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshin: pagesa e transmetimit live të Seancave të Kuvendit, pagesa për mbishkrimin “Urime Ramazani”, pagesa për inçizimi, fotografime, mirënjohje, shërbime zërimi dhe ftesa për nevoja të Drejtorisë së Kulturës si dhe pagesa e servisimit, kalibrimit të pajisjeve dhe aparaturave në QKMF.

13480- Shpenzime për Anëtarësim – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshin pagesën anëtarësimit në Asociacionin e Komunave të Kosovës në shumë prej 1,410.45 € dhe shuma prej 990.00 € për AZHR Lindje.

13501 – Mobilje - pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshin pagesën prej 2,394.00 € për 28 dollap për nevoja të SHFMU “Kështjella e Diturisë”.

13509 – Pajisje tjera - te ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa në shumë prej 1,198.00€ për furnizim me dy TV-ja për nevoja të Administratës Komunale.

13610 – Furnizim për zyrë - te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për furnizim me letra A4 për nevoja të Administratës Komunale, Sektori i Arsimit dhe i Shëndetësisë, furnizim me kimika, municion, cd-ja, bacteria, folldera, furnizim me receta për barna, udhëzues, kartela të vaksinimit, fletëza kompjuterike, protokole, udhëzime specialistike dhe laboratorike për nevoja të QKMF-së. Pagesa tjera nga ky kod ekonomik janë bërë për nevoja të Institucioneve Arsimore, material shkollor.

13620 – Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) – nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa prej 10,817.76 € për shërbime të byfësë ndërsa pjesa tjetër e pagesave nga ky kod ekonomik ka të bëjë me furnizime me produkte ushqimore për nevojat e Çerdhes.

13630 – Furnizime mjekësore – nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 është ekzekutuar pagesa prej 6,816.00 € për furnizim me eproveta, reagensa, ujë të destiluar, kiveta rotori, llanceta, acid solucion etj për nevoja të QKMF-së.

13640 – Furnizime pastrimi - pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 përfshin: pagesa me furnizime pastrimi për nevoja të Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit dhe Shëndetësisë si dhe nevoja të Zjarrfiksave.

13760 – Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje - Ka të bëjë me pagesën e furnizimit me dru për nevojat e të gjithë Institucioneve Publike në Komunë, në shumë prej 1,940.00 €.

13780 – Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri – Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për derivate për gjenerator për nevoja të Administratës Komunale, Sektori i Arsimit dhe i Shëndetësisë si dhe Zjarrëfiksat në vlerë prej 10,832.52 €,

13810 – Avancë (Paradhënia) për para të imëta – ky kod përfshin pagesa të cilat janë nën 100 € dhe për të cilat nuk zhvillohet procedura të prokurimit por që ndodhin ad hoc.

13950 – Regjistrimi i automjeteve – Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për regjistrimin e automjeteve komunale në vlerë prej 555.00 €,

13951 – Sigurimi i automjeteve - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për sigurimin e automjeteve komunale në vlerë prej 4,002.71 €,

14010 – Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për larjen, servisimin dhe riparimin e automjeteve komunale në vlerë prej 4,859.50 €,

14022 – Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për mirëmbajtjen e gjithë objekteve të Institucioneve Publike në vlerë prej 773.00 €,

14023 – Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për angazhimin e 4 punëtorëve teknik nëpër shkolla në shumë prej 9,600.00 € dhe pagesa prej 2,965.00 € për furnizim me material për mirëmbajtje.

14024 - Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa prej 1,600.00 € për angazhimin e një punëtori teknik në QKMF për 4 muaj dhe pagesa prej 420.00 € material për mirëmbajtje.

14030 – Mirëmbajtja e autorrugëve – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 ka të bëjë me riparimin e tabelës digjitale në shumë prej 4,956.00 €, pagesa prej 995.00 € për rregullimin e ndriçimit publik te Eksodi 99.

14032 – Mirëmbajtja e autorrugëve lokale - Te ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 janë përfshirë pagesa prej 36,341.10 € për NPL “Pastrimi” për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve, mirëmbajtjen e varrezave, mirëmbajtjen e parqeve publike, pagesa prej 4,964.00 € për zhbllokimin e kanalizimeve, pagesa prej 9,467.30 € për mirëmbajtjen e ndriçimit public në zonën urbane dhe rurale, pagesa prej 975.00 € për kapak metali, plastike dhe betony për puseta.

14310 – Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për dreka të cilat përfshin: drekë për Ekipin nga Maqedonia Veriore për projektin e IPA fondeve , drekë për aktivist të Avicena Ks, drekë për përfaqësues të Agjensisë Pyjore të Kosovës, Fondacionit CNVP dhe LAB-it, drekë për ekipin e Mamografisë, drekë për përfaqësues të OSBE-së, drekë për përfaqësues të Karvanit Shëndetësor “për Shëndet je”, drekë me përfaqësues të FSK-së, drekë për përfaqësues të UN-WOMEN në kuadër të projektit Gender Equality Fascility, drekë për pjesëmarrësit në punëtori “Funksionimi dhe bashkpunimi i Komunës me mekanizmat Komunal për pjesëmarrje”, drekë për ekipin udhëheqës dhe aktorët e Shfaqes “Monologjet e vrara”, drekë për përfaqësues të Organizatës GEG për bashkpunim në fushën e Arsimit, drekë për përfaqësues të Agjensionit për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore, drekë me përfaqësues të Komunës së Prizrenit, drekë dhe pije për ekipin dhe realizues të Shfaqes “Të Hidhëruarit”, drekë për mysafir të Kryetarit nga Mërgata, drekë për Ekipën Punuese për Bashkpunime Rajonale, pije për udhëheqësit dhe nxënësit që ishin pjesë e Shkollës Dimërore të Sikijimit “Drejt Malit”, drekë për Ekipën Punuese të projektit për hartimin e Elaboratit të kryer nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, drekë për Ekipin e projektit mes MAPL dhe USAID për evidentimin e pasurive kulturore, drekë me përfaqësues të Organizatës Cyber 4 Kosova për Nënshkrimin e Marrëveshjes mes OB-së dhe Organizatës, drekë për aktorët dhe ekipin realizues të shfaqes për fëmijë “Libri Magjik”, kafe dhe pije për pjesëmarrës në Homazhe për përvjetore të

Dëshmorëve dhe shënimin e datave tjera historike, iftarë për përfaqësues të familjeve të dëshmorëve dhe OJQ-ve të dalura nga lufta, drekë për shoqatën Handikos, iftar me të rinjë vullnetar në Komunitet, drekë për Edicionin e III të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar – Hani Elezit për pjesëmarrësit dhe të ftuarit, në shumë prej

14410 – Shpenzime - Vendime të gjykatave – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 ka të bëjë me vendime gjyqësore që përfshinë pagesat për shujta të Administratës Komunale dhe Kontrata Kolektive si dhe një pagesë për ngarkesën e taksës për ushtrim të veprimtarisë ekonomike.

14420 – Vendimet Administrative – Neni 39.2 LMFP – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025, ka të bëjë me pagesën e Anëtarëve të Komisionit për evidentimin e dëmeve të breshërit, pagesa e një tatim paguesi që ligjërisht lirohet nga kjo ngarkesë vjetore si dhe pagesa për vëllim të shtuar të punës për zyrtarin ligjor.

3.6 KATEGORIA SHPENZIME KOMUNALE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

3	Shpenzimet komunale	Shpenzimi Janar- Qershor 2025	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Krahasimi 2025-2024	Krahasimi në %
13210	Energjia Elektrike	37,308.43	21,938.80	15,369.63	70.06
13220	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	1,067.01	2,911.19	-1,844.18	- 63.35
13230	Mbeturinat	7,550.40	6,923.62	626.78	9.05
13250	Telefonia fikse	561.02	552.01	9.01	1.63
13260	Vendime gjyqësore	-	6,702.93	-6,702.93	- 100.00
	Totali për shpenzime komunale	46,486.86	39,028.55	7,458.31	19.11

13210 – Energjia Elektrike – Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e energjisë elektrike/rrymës për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 37,308.43 €.

13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit - – Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e ujësjellësit dhe kanalizimit për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 1,067.01 €.

13230 – Mbeturinat - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e mbeturinave për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 7,550.40 €.

13250 – Telefonia fikse - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e telefonisë fikse për Administratën Komunale dhe Sektori i Shëndetësisë në shumë prej 561.02 €.

3.7 KATEGORIA SUBVENCIONE DHE TRANSFERE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimi Janar- Qershor 2025	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Krahasimi 2025-2024	Krahasimi në %
21200	Subvencione për entitete jo-publike	36,225.00	31,710.00	4,515.00	14.24
22200	Transfere sociale për individë	-	999.00	-999.00	- 100.00
22202	Transfere për përfitues individual tjerë	57,649.68	41,712.00	15,937.68	38.21
22300	Vendime gjyqësore	12,600.00	-	12,600.00	#DIV/0!
	Totali në subvencione dhe transfere	106,474.68	74,421.00	32,053.68	43.07

21200 – Subvencione për entitete jo-publike – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 ka të bëjë me subvencionimin e OJQ-ve nga thirrja publike e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, pagesa ndaj Banjës së Klllokotit për rehabilitimin e pensionistave, familjet e dëshmorëve dhe anëtarët e Handikos, si dhe pagesat për Bashkësinë Islame për shpenzimet e varrimit.

22202 - Transfere për përfitues individual tjerë – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 ka të bëjë me bursat e studentëve, përkrahjen e lehonave, ndihma financiare për qytetarë në gjendje të rënda shëndetësore, subvencionimi i bizneseve nga thirrja e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, përfituesit (fermerët) e thirrjes publike nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

22300 - Vendime gjyqësore – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025 ka të bëjë me Vendimet Gjyqësore nga Kontrata Kolektive.

3.8 KATEGORIA SHPENZIME KAPITALE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

5	Investimet kapitale	Shpenzimi Janar- Qershor 2025	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Krahasimi 2025-2024	Krahasimi në %
31230	Rrugët lokale	12,975.95	47,358.60	- 34,382.65	- 72.60
31250	Kanalizimi	-	28,702.70	- 28,702.70	- 100.00
31610	Pajisje tjera të teknologjisë Informative dhe të komunikimit	21,700.00	-	21,700.00	#DIV/0!
31690	Pajisje tjera	29,672.70	-	29,672.70	#DIV/0!
31701	Kamionë	22,487.50	-	22,487.50	#DIV/0!
34000	Pagesa-vendime gjyqësore	86,802.74	-	86,802.74	#DIV/0!
	Totali për investime kapitale	173,638.89	76,061.30	97,577.59	128.29
	Totali për të gjithë kategoritë buxhetore	1,758,538.44	1,534,321.17	224,217.27	14.61

SQARIM:

31230 – Rrugët Lokale – Pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2025, ka të bëjë me implementimin e këtyre projekteve: Ndriçimi publik te Varrezat e Dëshmoreve në shumë prej 5,000.00 € dhe 7,975.95 € për projektin “Ndërtimi i aneksit për këmbësor në Urën e Seçishtës”.

31610 – Pajisje tjera të teknologjisë Informative dhe të komunikimit pagesa nga ky kod ka të bëjë me furnizimin me drone nga projekti “Sistemi i zgjuar për zbulimin e hershëm të përmytjeve dhe monitorimin e mbetjeve në pellgun e Lumit Lepenc” në shumë prej 7,740.00 €, dhe pagesa prej 13,960.00 € për pajisje të ndrsyhme të IT-së për projektin e njejtë.

31690 – Pajisje tjera – pagesa nga ky kod ekonomik ka të bëjë me instalimin e popmave termike, dhe senzora për projektin e Ipa Fondeve.

31701 – Kamionë – kemi bërë parapagim për kamion për mbeturina për kamionin për projektin e bashkfinancuar me Ipa fonde.

34000 - Pagesa-vendime gjyqësore – Për periudhën janar-qershor 2025, janë ekzekutuar 86,802.74 € nga ky kod ekonomik për lëndë me përmbarrim – Kontrata Kolektive.

3.9 RAPORT I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTEVE KAPITALE JANAR-QERSHOR 2025

Përshkrim	Debi
180 – Shërbime publike, mbrojtja civile dhe Emergjenca	5,000.00
56224 - Rregullimi i ndriçimit te varrezat e dëshmorëve në fshatin Pustenik	5,000.00
660 - Planifikimi urban dhe mjedisi	90,635.90
55048 - Asfaltimi i rrugës "Nehat Curri", lagja Curri - Dromjak	23,577.45
92180 - Sistemi i zgjuar për zbulimin e hershëm të përmytjeve dhe monitorimin e mbetjeve në pellgun e Lumit Lepenc	59,082.50
95933 - Ndërtimi i aneksit për këmbësor në Urën e Seçishtës	7,975.95
920 - Arsim dhe shkencë	78,002.99
56028 - Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaçi, SHFMU - Kështjella e Diturisë, SHFMU - Veli Ballazhi dhe IP Ardhmëria	18,387.70
56091 - Investime në pajisje të IT-së në shkollat SHML Dardania, SHFMU Ilaz Thaçi, SHFMU Veli Ballazhi dhe SHFMU Kështjella e Diturisë.	59,615.29
Bilanci i përgjithshëm	173,638.89



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA - MUNICIPALITY

HANI I ELEZIT



Nr. 04 5247/2025

DATA:	14.07.2025
PËR:	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hani të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Raporti i Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 nga ZKA

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar/a Anëtar/e të Kuvendit Komunal,

Gjeni të bashkangjitur Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, me numër protokolli 04/47/1056 e datës 20.06.2025.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Hanit të Elezit (KHE), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Hanit të Elezit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B1 Në tri raste të obligimeve në vlerë 24,9314€, kishte vonesa në pagesës nga 14 deri 284 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

ZKF është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, ZKF është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Hanit të Elezit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Hanit të Elezit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Hanit të Elezit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Hanit të Elezit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Hanit të Elezit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: nënvlerësimi i pasurive dhe keqklasifikim i shpenzimeve. Përderisa çështjet e pajtueshmërisë që kanë rezultuar lidhen me vonesat në pagimin e obligimeve financiare, rritje të llogarive të arkëtueshme, dhe me mos themelim të Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Pas rishikimit të PVF-ve 2024 janë identifikuar gabime dhe duke u bazuar në rekomandimet e auditorit në shkurt 2025, menaxhmenti ka ndërmarrë masa për korrigjimin e pasqyrave financiare, duke siguruar që ato të jenë të sakta dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim i ri dhe katër (4) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari

Gjetja Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e funrizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Në tri raste në vlerë 24,9314€, kemi identifikuar vonesa në ekzekutimin e faturave/obligimeve kontraktuale përtej afatit të përcaktuar. Vonesat ishin nga 14 deri 284 ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 ditëve.

Gjithashtu, bazuar në mostrat tona të pagesave prej 27,791€ si rezultat i procedurave përmbarimore dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesën me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, si dhe obligimeve nga kontrata kolektive për personelin arsimor, në emër të kamatave, tarifave të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore, janë paguar kosto shtesë në vlerë 11,182€.

Hyrja në obligime është si shkak i mungesës së kontrolleve të brendshme për pagesën me kohë të obligimeve.

Ndikimi Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, kanë ndikuar që komuna të jetë subjekt i padive nga kontraktuesit, duke shkaktuar kosto shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore dhe përmbarimore. Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe menaxhimin e tyre, duke siguruar fonde të mjaftueshme si dhe pagesën me kohë të faturave, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investimet kapitale ishte 793,983€, dhe gjatë vitit 2024 ishin shpenzuar 470,563€ apo 59%.

Çështja A1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja	Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Në dy (2) raste të pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendimet përmbartimore në vlerën 27,791€, shpenzimet që për nga natyra e i takojnë pagave dhe mëditjeve, janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale. Këto shpenzime kishin të bëjnë për obligimet e kontratës kolektive për paga jubilarë dhe shujta, për punonjësit e arsimit. Kjo ka rezultuar në mbivlerësimin financiar të shpenzimeve të kategorisë së investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e kategorisë së paga dhe meditje. Kjo ka ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të buxhetit për detyrimet e mundshme në kategorinë përkatëse ekonomike.
Ndikimi	Pagesa e shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF. Shfrytëzimi i buxhetit të investimeve kapitale për pagesën e shpenzimeve që i takojnë pagave dhe mëditjeve, ka reflektim negativ duke vështirësuar apo edhe pamundësuar realizimin si duhet të projekteve kapitale.
Rekomandimi A1	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse dhe në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 16,546,454 €, pasurive jokapitale 133,966.31 €, si dhe e stoqeve 1,779€.

Çështja B2 - Nënvlërësim i regjistrit të pasurisë në PFV

Gjetja

Neni 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu neni 11 paragrafi 1 dhe 2 i rregullores përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim dhe nuk zhvlerësohen.

Pasuritë e prezantuara në PFV ishin nënvlerësuar për 177,172€, për shkak se investime të paguara gjatë vitit 2024 për ndërtimin e rrugëve, trotuareve, kanalizimeve, infrastrukturës shkollore etj., nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale të SIMFK-së. Pasuri në vlerë 139,172€¹, ishin projekte të përfunduara dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim, derisa pasuri në vlerë 38,000€¹, ishin pagesa për projekte që nuk kanë përfunduar dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në vijim.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat kontabël ndikon në nënvlerësim të pasurive dhe paraqitje jo të saktë të informative në PVF.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Hanit të Elezit në PFV e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 515,775€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 200,431€, taksa për ushtrimin e veprimtarisë 305,337€ dhe qiraja nga prona publike 10,007€.

Çështja B3 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove. Sipas nenit 27, të ligjit të njëjtë, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pages, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna ka shpalosur në pasqyren financiare të vitit 2024 llogari të arkëtueshme në vlerë totale 515,775€. Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje dhe në krahasim me vitin paraprak rritja e tyre është 162,757€. Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga tatimi në pronë. Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime në inkasimin e borxheve përmes paralajmërimeve apo edhe procedurave të përmbarimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në mbledhjen e të hyrave, mos marrja e veprimeve ligjore ndaj debitorve, si dhe nga bartja e borxheve të vjetra.

Ndikimi

Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitorët mund të shkaktoj probleme në pëëmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhi të inkasohen.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes marrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Funkcioni i auditimit të brendshëm

Çështja B4 - Mos themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Gjetja	Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi tre (3) milion euro themelon Njësinë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë se paku dy auditor. Komuna e Hanit të Elezit edhe pse në vitin 2024 kishte buxhet mbi 4 milion euro, ndërsa nuk e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, siç kërkohet me rregullën përkatëse. Kjo kishte ndodhur për shkak se Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e themelimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
Ndikimi	Mos themelimi i NjAB-së, përveç së është në kundërshtim me kërkesat ligjore i pamundëson menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohe sa me të hershme.
Rekomandimi B4	Kryetari, duhet të marr veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	3,349,278	4,010,574	3,583,669	3,453,882	2,704,228
Grante Qeveritare - Buxheti	3,074,902	3,140,771	3,034,166	3,008,702	2,318,493
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	20,286
Të bartura nga viti i kaluar	0	133,030	124,143	115,613	62,486
Të hyrat vetanake	274,376	274,376	155,136	298,703	243,823
Donacionet vendore	0	30	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	462,367	270,224	30,864	59,140

Buxheti final për vitin 2024 është rritur për 661,296€ krahasuar me buxhetin fillestar, ose 19.7% më shumë. Kjo rritje vjen kryesisht nga granti qeveritar, donacionet e jashtme dhe të hyrat e bartura nga viti paraprak.

Nga buxheti final, janë realizuar gjithsej 3,583,669€, ose 89% e buxhetit total, me një rritje modeste krahasuar me vitin 2023.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	3,349,278	4,010,574	3,583,669	3,453,882	2,704,228
Pagat dhe mëditjet	2,075,272	2,141,141	2,141,141	1,987,398	1,694,968
Mallrat dhe shërbimet	524,500	609,155	519,787	472,647	396,616
Komunalitë	93,500	93,500	81,220	88,798	67,684
Subvencionet dhe transferet	113,000	372,795	370,958	86,955	85,967
Investimet Kapitale	543,006	793,983	470,563	818,084	458,992

Në vijim paraqitet analiza e realizimit sipas kategorive kryesore:

-Buxheti final për pagat dhe mëditjet, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 65,869€. Shpenzimet për këtë kategori janë realizuar në 100% të buxhetit final.


-Buxheti final për mallrat dhe shërbimet, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 84,655€. Shpenzimet për këtë kategori kanë arritur të realizoheshin në 85% të buxhetit.

-Buxheti final për shërbimet komunale ka mbetur i njëjtë me buxhetin fillestar, 93,500€. Shpenzimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 87%.

-Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 259,795€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet të kësaj kategori ishin 99.51% e buxhetit final.

-Buxheti final për investime kapitale është rritur për 250,977€ krahasuar me buxhetin fillestar. Realizimi i investimeve kapitale ishte vetëm 59% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara në vitin 2024 ishin në vlerë 246,053€. Ato përfshijnë të hyrat nga tatami në prone, participimet dhe shërbime të ndryshme, etj. Krahasuar me vitin 2023, të hyrat janë ulur për 31.30% apo për 112,079€. Në shumën totale të pranimeve për vitin 2024, nuk janë të përfshira edhe të hyrat nga gjambat në trafik nga MPB, gjambat nga Gjykatat dhe Agjencioni i Pyjeve në vlerë prej 70,967€, të cilat grumbullohen nga insitucionet përkatëse dhe i alokohen Komunës për shpenzim.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	274,376	274,376	246,053	358,132	334,002
Të hyrat tatimore	183,913	183,913	75,870	160,835	163,301
Të hyrat jo tatimore	90,463	90,463	170,183	197,297	170,700

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Hanit të Elezit (HE) ka rezultuar me pesë (5) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. HE ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar. Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, katër (4) nga rekomandimet nuk janë zbatuar, ndërsa një (1) është mbyllur. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj që procesit të blerjeve t'i paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të vazhdohet me tej me përgatitjen e urdhërblërjes për punët, furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.	Për shkak të rëndësisë dhe natyrës së këtyre shpenzimeve rekomandimi është mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.	Nuk janë ndërmarra veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes marrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Nuk janë ndërmarra veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimin të faturave.	Nuk janë ndërmarra veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të marr veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Nuk janë ndërmarra veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Hanit të Elezit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Z. Mehmet Ballazhi

Pozita: Kryetar i Komunës

Data: 12.06.2025

Nënshkrimi: 





Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. -“Shtrim me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatra” pagesa në vlerë 40,000€;
-“Rregullimi i kanalizimit në Han të Elezit rruga Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatra” pagesa në vlerë 28,703€; -“Ndërtimi i rrugës nën breg në fshatin Seçishtë” pagesa në vlerë 29,534€; -“Rregullimi i infrastrukturës shkollore” pagesa në vlerë 40,935€; 2. -“Ndërtimi i mureve mbrojtëse” pagesa në vlerë 20,000€;
-“Shtimi i kapaciteteve të ujit në lagjen e re dhe në Han të Elezit” pagesa në vlerë 18,000€;
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA - MUNICIPALITY

HANI I ELEZIT



Nr. 04 / 528 / 2025

DATA:	14.07.2025
PËR:	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hani të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Plani i Veprimit të zbatimit të rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,

Të nderuar/a Anëtar/e të Kuvendit Komunal,

Bazuar në nenin 23, pika 5 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe duke u bazuar Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, me numër protokolli 04/47/1056 e datës 20.06.2025, Komuna Hani i Elezit ka përgatitur Planin e Veprimit të zbatimit të rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024.

Me respekt,

**Plani i Veprimit të zbatimit të rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e
Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024**

Nr	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës / Drejtoria	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja B1 – Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga Thesari	Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMPPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmba ruesi. Në tri raste në vlerë 24,931.4€, kemi identifikuar vonesa në ekzekutimin e faturave/obligi	Kryetari duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe menaxhimin e tyre, duke siguruar fonde të mjaftueshme si dhe pagesën me kohë të faturave, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.	Do të shtohet kontrolli në ekzekutimin e pagesave në afatin e paraparë Ligjor, përveç lëndëve nga Kontrata Kolektive të cilat i ekzekuton Thesari pa paralajmërim	Drejtoria për Buxhet dhe Financa Drejtoritë tjera të cilat krijojnë obligime	Korrik-Dhjetor 2025	Arsyeja e disa vonesave në ekzekutimin e obligimeve financiare është si pasojë e ekzekutimit të mjeteve drejtpërdrejt nga Thesari (Kontrata Kolektive), me ç'rast kemi mbetur pa mjete në një Nën-Program dhe kategori buxhetore ku edhe është krijuar obligimi i rregullt financiar.

		meve kontraktuale përtej afatit të përcaktuar. Vonesat ishin nga 14 deri 284 ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 ditëve. Gjithashtu, bazuar në mostrat të pagesave prej 27,791€ si rezultat i procedurave përmbartimore dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesën me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, si dhe obligimeve nga kontrata kolektive për personelin arsimor, në emër të kamatave, tarifave të përmbartimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore, janë paguar kosto shtesë në vlerë 11,182€.					
2	Çështja A1 – Keqklasifikim i i shpenzimeve	Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i	Në rastet prej të cilat ka rezultuar kjo e gjetur si OB nuk kemi përgjegjësi se mjetet janë ekzekutuar drejtpërdrejt nga Thesari pa paralajmërim.	Drejtoria e Financave,	Korrik-Dhjetor 2025	OB-ja në rastet e gjetura nuk është përgjegjëse pasiqë Thesari i ekzekuton shumicën e lëndëve pa

		adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Në dy (2) raste të pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendimet përmbare në vlerën 27,791€, shpenzimet që për nga natyra e i takojnë pagave dhe mëditjeve, janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale. Këto shpenzime kishin të bëjnë për obligimet e kontratës kolektive për paga jubilarë dhe shujta, për punonjësit e arsimit. Kjo ka rezultuar në mbivlerësimin financiar të shpenzimeve të kategorisë së	kategorive dhe kodeve përkatëse dhe në përputhje me planin kontabël të Thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.	Megjithatë, për obligime tjera të cilat krijohen do të shtohet kontrolli që këto obligime të ekzekutohen në përputhje me planifikimet buxhetore dhe kodet ekonomike përkatëse.			paralajmërim dhe pa aprovimin tonë paraprak. Kemi bërë kërkesa në Thesar që kur të pranohen për ekzekutim lëndët nga Gjykata apo Përmbare e të na njoftojnë dhe të marrin aprovimin tonë për linjat buxhetore, në mënyrë që më tutje mos kemi implikime financiare.
--	--	--	--	---	--	--	--

		investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e kategorisë së paga dhe mëditje. Kjo ka ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të buxhetit për detyrimet e mundshme në kategorinë përkatëse ekonomike.					
3	Çështja B2 – Nënvlërësim i regjistrimit të pasurisë në PFV	Neni 6, paragrafi 3 i Rregullores 02/2023 për menaxhimin e pasurive jo financiare në Organizatat Buxhetore përcakton që: Pasuria kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale duhet të regjistrohet në sistemin E-pasuria. Poashtu, neni 11, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores përcakton se pasuritë jofinanciare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në	Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.	Do të shtohet kontrolli i regjistrimit të pasurive	Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Korrik-Dhjetor 2025	Do të shtohet kontrolli edhe gjatë hartimit të PFV

		kategorinë e investimeve në vijim dhe nuk zhvlerësohen. Pasuritë e prezantuara në PFV ishin nënvlerësuar për 177,172 € për shkak se investimet e paguara gjatë vitit 2024 për ndërtimin e rrugëve, trotuareve, kanalizimeve, infrastrukturës shkollore etj nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale në SIMFK-së. Pasuri në vlerë 139,172 € ishin projekte të përfunduara dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim, derisa pasuri në vlerë 38,000 €, ishin pagesa për projekte që nuk kanë përfunduar dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në vijim.					
--	--	---	--	--	--	--	--

4	Çështja B3 – Të arkëtueshmet	Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme me nr. 06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) €. Sipas nenit 27, të ligjit të njëjtë, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se (10) ditë	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes marrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese.	Do të shtohet kontrolli në inkasimin e të hyrave.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Inspeksioni t	Korrik-Dhjetor 2025	Do të bëhen njoftime për afatet e pagesave, Do të ofrohen lidhje të marrëveshjeve për pagesë me këste të obligimeve si dhe do të ndërmerren edhe masa tjera ligjore.
---	------------------------------------	---	--	---	--	---------------------	--

		kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Komuna ka shpalosur në PFV 2024, llogari të arkëtueshme në vlerë totale 515,775 . Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje dhe në krahasim me vitin paraprak rritja e tyre është 162,757 €. Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga tatimi në pronë.					
5	Çështja B4 – Mos themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm	Rregulloren QRK Nr 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi tre (3) milion euro themelon Njësinë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë së paku dy auditor. Komuna Hani i Elezit edhe pse në vitin 2024	Kryetari duhet të marrë veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohësisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Do të ri-përsërimin kërkesat tona si OB për aprovim të numrit të stafit sepse momentalisht nuk kemi pozita të lira në Administratë Komunale.	Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Korrik-Dhjetor	Kemi bërë kërkesa në MFPT për aprovim të një numri të caktuar të stafit për të cilat ka nevojë Komuna.

		kishte buxhet mbi 4 milion euro, ndërsa nuk e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, siç kërkohet me rregullën përkatëse.					
--	--	--	--	--	--	--	--



Republika e Kosovës - Republik of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/Nr. 5296/2025

DATA:	14.07.2025
PËR:	Komitetin për Politik e Financa dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	Kryetari i Komunës z.Mehmet Ballazhi <i>M. Ballazhi</i>
LËNDA:	Shkresë përcjellëse: Informate për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2025.

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim njoftimin për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2025.

Me respekt

**INFORMATË PËR AKTIVITETE E KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI PËR GJASHTË MUJORIN E VITI 2025**

Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive në komunën e Hanit të Elezit për gjashtë mujorin e vitit 2025 ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta.

Në takimet e rregullta të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive zakonisht marrin pjesë:

1. Kryetari i komunës si kryesues i këshillit
2. Komandanti i stacionit policor
3. Përfaqësuesi i policia kufitare vija e gjelbërt
4. Përfaqësuesi i këshillit të bashkësisë islame
5. Kryesuesi i komitetit për komunitete
6. Përfaqësuesi për barazi gjinore
7. Drejtori i drejtorisë për arsim
8. Përfaqësuesi i këshillit të prindërve
9. Përfaqësuesi i FSK-së
10. Drejtori i drejtorisë për shërbimeve publike dhe emergjencë
11. Përfaqësuesi i KVRL-së

Çështjet të cilat u trajtuan:-

- Siguria në komunën tonë.
- Siguria në Komunikacion.
- Çështja e investimeve kapitale që i ka komuna dhe pronat të cilat i posedon janë tu pasur shumë dëmtime siç po e shohim te parku i qytetit, parku Bllaca 99, te parku te Ura e Seçishtës dhe dëmtimet tjera që po bëhen në vazhdimësi në prona publike, dhe është kërkuar prej policisë që të ketë një angazhim pak më të madh sa i përket kësaj çështje.
- I është rekomanduar policisë për çështjen e parkingut që është për persona me aftësi të kufizuara që mos të jetë i zënë.
- Është rekomanduar që policia të vazhdon të qëndronë në pikën te shkolla fillore "Ilaç Thaçi në dy ndërrime.
- Është diskutuar çështja e dukurive negative edhe nëpër fshatra , droga, bixhozi teknologjik dhe është kërkuar nga policia që t'i njofton njësitet përgjegjëse të policisë për këtë çështje dhe të bashkëpunon me qytetarë për këtë çështje.
- Vendosija e zebrave .
- Është diskutuar çështja e qenve endacak por nuk kemi mundur me bërë asgjë për shkak se Ligji nuk na lejon.
- Çështja e migrantëve ilegal.
- Çështja e dëmtimit të ndriçimit publik te rruga "Ekzoti 99".
- Çështja e rrugës Hani i Elezit –Gorancë-Gllloboçicë.



Republika e Kosovës – Republic of Kosova
Ndërmarrja Publike Lokale
“PASTRIMI”SH.A
Hani Elezit



01/Nr. 4934/2025

Data:	07.07.2025
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES:	Kryesues e Komisionit të Aksionerëve – Sevime Bajrami
NGA:	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL“PASTRIMI”SH.A
LËNDA:	Informatë mbi Raportin gjashtë mujor Janar – Qershor 2025

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Me anë të kësaj shkrese po ua përcjelli raportin gjashtë mujor janar - qershor /2025 të Ndërmarrjes Publike Lokale të Mbeturinave - NPL“Pastrimi”Sh.a.

Me respekt,

**RAPORTI PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR / 2025 I NDËRMARRJES PUBLIKE
LOKALE TË MBETURINAVE - NPL"PASTRIMI" SH.A**

Ky raport është përgatitur për periudhën Janar – Qershor / 2025, në bazë të ligjit për Ndërmarrjet Publike - Ligjit Nr.03/L-087, të nenit 31 dhe nenit 14, paragrafit 14.2 dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a, Ndërmarrja Publike Lokale – NPL "PASTRIMI" SH.A, bënë menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunësse Hanit të Elezit, ku përfshihen të gjitha lokalitetet e Komunës.
Ndërmarrja Publike Lokale – Npl"Pastrimi" Sh.a, ka gjithësej njëzete një punëtor(21) punëtorë :-

- 1 Kryeshef Ekzekutiv
- 1 Sekretar i Ndërmarrjes
- 1 Arkëtare (ushtruese detyre e ZKF –së)
- 1 Zyrtar i Prokurimit
- 1 Inkasant
- 1 Mirembajtës i parqeve publike
- 3 Shofer
- 4 Punëtor teknik
- 8 Pastrues (Grumbullues të mbeturinave)

Sa i përket kësaj periudhe Janar – Qershor2025, mund të themi se gjatë kësaj periudhe ka qenë një periudhë me mjaftaktivitete nga punëtorët e ndërmarrjes publike lokale "Pastrimi". Gjatë kësaj periudhe punëtorët e kompanisë kanë qenë të angazhuar në terren në kryerjen e shërbimit të mbeturinave dhe njëkohësisht kanë kryer pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në qendër të Hanit të Elezit, pastrimin e rrugëve në fshatra përreth, pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve në Pustenik, pastrimin dhe mirembajtejn e parkut te qytetit "Isa Berisha", krasitjen e pemëve dekorative në qendër të Hanit të Elezit,pastrimin e përronjëve si atë në Seçishtë dhe tek perroi i Dimcës.

Sa i përket politikave te arkëtimit te obligimeve nga ana e klientëve, kompania ka angazhuar stafin ne mbledhjen e detyrimeve te pa paguara duke dërguar njoftime me shkrim ne forme te kërkesës tek klientët per pagesën e obligimit. Pas këtij aksioni kemi pasur pergjigjeje pozitive nga ana e klientëve ne pagesën e detyrimeve.

Lista e punëtorëve të NPL-së, pozita e vendit të punës dhe paga e tyre si vijon:-

Nr.	Pozita	Nr. Punëtorëve	Paga Bruto
1	Kryeshefi Ekzekutiv	1	880.82
2	Sekretar i Ndërmarrjes	1	568.21
3	Arkëtare	1	568.21
4	Mirëmbajtës i parqeve publike	1	447.35
5	Shofer	2	512.84
6	Shofer – mbykqyres i punëtorve në teren	1	568.21
7	Inkasant	1	512.84
8	Grumbullues i mbeturinave	8	447.35
9	Punëtor teknik	4	447.35
10	Zyrtar i prokurimit	1	155.86
11	TOTALI I STAFIT TË NPL-SË	21	

Gjatë periudhës Janar –Qershor /2025, janë mbajtur gjashtë (6) mbledhje me Bordin e Drejtorëve të Npl "Pastrimi" Sh.a. ;

Gjatë muajit Maj është propozuar nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe me miratim nga anëtarët e bordit është bërë ngritja e pagesës së shujtave për punëtorët nga 2.00 € ne 4.00 € bruto në ditë , me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe motivimin e stafit.

Ky ndryshim ka hyre në fuqi menjëherë nga data 1 maj 2025 dhe aplikohet për të gjithë punonjësit aktivë të

NPL-së, gjithëashtu për punëtorët të cilët kryejnë punë në ndërrimin e natës te cilët janë të ndarë në dy grupe nga 3 punonjës, në bazë të orarit të përcaktuar , kompenzohen për orët shtesë sipas legjislacionit në fuqi .

Pagesa për orët shtesë realizohet mbi pagën bazë, në përputhje me evidencën mujore të orarit te punës.

Çmimet e kontratave janë:-

- Kontratë familjare **6.50 €**, në muaj,
- Kontratë e mesme **10.40 €**, në muaj,
- Kontratë me zbrazje **16.90 €**, për çdo zbrazje të kontenjerit **1100L**.

Gjatë periudhës Janar–Qershor /2025 janë nënshkruar disa kontrata me klient të rinj të Npl"Pastrimi" Sh.a, ato janë:

- Kontratë familjare **4**,
- Kontratë biznesore **9**,
- Institucionale **0**.

Totali i kontratave të nënshkruara nga viti 2017 – Qershor / 2025 janë si vijon:

- Ekonomitë familjare ----- **1336**
- Kontratë biznesore ----- **113**
- Kontratë institucionale ----- **11**
- Totali i kontratave ----- **1460**

1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2025, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të nenit 14, paragrafët 14.2 si dhe statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale.

Ky raport përmban një përmbledhje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore të kompanisë së mbeturinave përgjatë periudhës Janar – Qershor 2025. Raporti pasqyron të hyrat e kompanisë, si dhe krahasimet me periudhën paraprake.

Performanca e të hyrave nga shërbimet

Të hyrat nga shërbimet në periudhën raportuese Janar – Qershor 2025 kanë arritur vlerën **123,877.73** euro duke shënuar trende rritëse me **12.16%** që korrespondon me **13,426.84** euro më shumë krahasuar me të hyrat e të njëjtës periudhe të vitit 2024.

Performanca e shpenzimeve të kompanisë

Shpenzimet e kompanisë në periudhën raportuese kanë arritur vlerën prej **115,458.01** euro duke shënuar një rritje prej **9.57 %** që korrespondon me **5,285.43** euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

- Shpenzimet për paga dhe mëditje në periudhën raportuese shënuan vlerën e **62,442.19** € duke shënuar një rënie prej **431.84** € apo **1.10%** krahasuar me vitin 2024.
- Shpenzimet në tatime në periudhën raportuese shënuan vlerën prej **5,676.61** euro duke shënuar një rritje prej **852.99** euro ose në përqindje **17.68%** më shumë krahasuar me vitin 2024.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në periudhën raportuese shënuan vlerën prej **47,339.21** € duke shënuar një rritje prej **5,126.85** € apo **12.15 %** krahasuar me vitin 2024.

2. TË HYRAT E KOMPANISË

TE HYRAT	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1 TëhyratngaShërbimet	110,450.89	123,877.73	13,426.84	12.16%
2 Tëhyratjera	3,633.00	452.80	(3,180.20)	-87.54%
3 Parajanëbankë	511.04	1,229.82	718.78	140.65%
TOTALI	114,594.93	125,560.35	10,965.42	9.57%

3. SHPENZIMET E KOMPANISË

3.1 PAGA DHE MËDITJE

A PAGAT DHE MEDITJET	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1 PAGAT NETO + SHUJTA	54,623.99	54,415.90	(208.09)	-0.38%
2 KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	3,000.69	2,973.45	(27.24)	-0.91%
3 KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	3,000.69	2,973.45	(27.24)	-0.91%
4 TATIMI NE BURIM	2,511.23	2,079.39	(431.84)	-17.20%
TOTALI	63,136.60	62,442.19	(694.41)	-1.10%

3.2 Tatimet

B	TATIMET	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	TVSH-ja 8%	4,823.62	5,676.61	852.99	17.68%
2	KESTET TREMUJORE (ATK)	-	-	-	-
3	TATIMI VJETOR MBI KORPORATA	-	-	-	-
	TOTALI	4,823.62	5,676.61	852.99	17.68%

3.3 MALLRA DHE SHERBIME

C	MALLRA DHE SHËRBIME	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Shpenzimepërkarburant	11,122.92	10,998.43	(124.49)	-1.12%
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	8,311.90	6,281.16	(2,030.74)	-24.43%
3	Shpenzimetpër internet	127.12	127.12	-	0.00%
4	Shpenzimet e Mirëmbajtjes se Mjeteve	10,932.71	16,253.81	5,321.10	48.67%
5	Furnizim me Rërë I II III		-	-	-
6	ShpenzimepërSoftuerKompjuterik	500.00	250.00	(250.00)	-50.00%
7	Shpenzime per zyredhe administrative	2,167.83	2,960.82	792.99	36.58%
8	Shpenzime per pajisjedhemjetepune	6,382.35	4,696.37	(1,685.98)	-26.42%
9	Shpenzimepërtrajtime		-	-	-
10	Shpenzimet e Reprerentacionit	436.30	558.40	122.10	27.99%
11	Shpenzimet e Sigurimit	9.03	1,994.62	1,985.59	21988.82%
12	ShpenzimeTelefoni - (Mbushje)	602.40	500.00	(102.40)	-17.00%
13	ProvizioneBankare NLB BANK	75.80	118.30	42.50	56.07%
14	Çertifikatapërshoferkamioni		-	-	-
15	Çertifikatashëndetsore		-	-	-
16	Shpenzimethixhienike		2,442.08	2,442.08	100.00%
17	Uniforma Pune			-	-
18	Licence			-	-
19	Shpenzimet e punes ne terren				
20	Shpenzimet e pazbritshme per qeshtjetatimore	1,544.00		(1,544.00)	100.00%
21	Shpenzimet e rrymes		158.10	158.10	100.00%
	TOTALI	42,212.36	47,339.21	5,126.85	12.15%

3.4 TOTALI I TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

	TE HYRAT	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	TëhyratngaShërbimet	110,450.89	123,877.73	13,426.84	12.16%
2	Tëhyratjera (Ministria e Punes)	3,633.00	452.80	(3,180.20)	-87.54%
3	Parajanëbankë	511.04	1,229.82	718.78	140.65%
	TOTALI	114,594.93	125,560.35	10,965.42	9.57%
	SHPENZIMET				
	Totaliishpenzimeve A+B+C+D+E	110,172.58	115,458.01	5,285.43	4.80%
	Fitimi/Humbja	4,422.35	10,102.34	5,679.99	128.44%

Hani i Elezit,

04.07.2025

Llogaritja e te hyrave dhe shpenzimeve Janar - Qershor 2025

N.P.L. - PASTRIM
NRU: 811167271

Hani i Elezit Rr. " D

TE HYRAT							
1 Të hyrat nga Shërbimet	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
2 Të Hyra Tjera (Ministria e Punës)	28,963.50	19,820.68	18,661.79	23,655.49	14,626.31	18,149.96	123,877.73
3 Paraja në bankë (Xhirologjaria 2024)	387.90	64.90					452.80
TOTALI	1,229.82	-					1,229.82
	30,581.22	19,885.58	18,661.79	23,655.49	14,626.31	18,149.96	125,560.35
SHPENZIMET E KOMPANISË							
A PAGAT DHE MEDITJET	1	2	3	4	5	6	
1 PAGAT NETO + SHUJTA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
2 KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	8,168.31	8,645.51	9,162.63	8,634.16	8,965.65	10,839.64	54,415.90
3 KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	444.62	470.83	501.19	470.95	490.48	595.38	2,973.45
4 TATIMI NE BURIM	444.62	470.83	501.19	470.95	490.48	595.38	2,973.45
5 MEDITJET E BORDIT	279.33	300.13	360.01	313.84	353.51	472.57	2,079.39
TOTALI	9,336.88	9,887.30	10,525.02	9,889.90	10,300.12	12,502.97	62,442.19
B TATIMET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
1 TVSH-ja 8%	1,056.31	951.13	1,014.07	758.23	779.60	1,117.27	5,676.61
2 KESTET TREMUJORE (ATK)							
3 TATIMI VJETOR MBI KORPORATA							
TOTALI	1,056.31	951.13	1,014.07	758.23	779.60	1,117.27	5,676.61
C MALLRA DHE SHËRBIME	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
1 Shpenzime për karburant	2,949.16	2,422.15	525.42	2,315.44	2,319.48	466.78	10,998.43
2 Shpenzimet e deponisë (KMDK)	1,602.07	1,721.23	-	1,465.47	1,492.39	-	6,281.16
3 Shpenzimet për internet	127.12	-	-	-	-	-	127.12
4 Shpenz. e mirëmbajtjes së mjeteve dhe objekteve	3,177.90	954.24	3,068.49	2,889.98	3,315.39	2,847.81	16,253.81
5 Furnizim me Krere I II III							
6 Shpenzime për Softwer Kompjuterik							
7 Shpenzime per Zyre dhe administrative	520.18	345.00	475.50	776.01	250.00		250.00
8 Shpenzime per pajisje dhe mjete pune	229.54		800.85	1,918.44	300.00	544.13	2,960.82
11 Shpenzime per trajnime					1,240.84	506.70	4,696.37
12 Shpenzimet e Reprerentacionit	106.30	96.00	155.00	105.10	96.00	-	558.40
13 Shpenzimet e Sigurimit	83.05	83.05	82.20	610.00	1,384.62		1,994.62
14 Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	31.10	20.40	18.70	83.90	83.90	83.90	500.00
15 Provizione Bankare NLB BANK				26.10	22.00		118.30
16 Certifikata per shofer kamioni							
17 Certifikata shendetore punetor							
18 Shpenzime hishicnike	2,346.32		49.15	46.61			2,442.08
19 Uniforma Pune							
21 Licenca							
22 Shpenzimet e punes ne terren							
23 Shpenzimet e pazbritshme per qeshtje tatimore							
TOTALI	11,172.74	5,642.07	5,175.31	10,237.05	10,504.62	4,449.32	47,181.11
D Shpenzime Komonale	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
1 Shpenzimet e Rrymes			103.67	26.51	27.92		158.10
TOTALI	-	-	103.67	26.51	27.92	-	158.10
TOTALI SHPENZIMEVE (A+B+C)	21,565.93	16,480.50	16,818.07	20,911.69	21,612.26	18,069.56	115,458.01

2. TË HYRAT E KOMPANISË

TE HYRAT	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1 Të hyrat nga Shërbimet	110,450.89	123,877.73	13,426.84	12.16%
2 Te hyra tjera	3,633.00	452.80	(3,180.20)	-87.54%
3 Paraja në bankë	511.04	1,229.82	718.78	140.65%
TOTALI	114,594.93	125,560.35	10,965.42	9.57%

3. SHPENZIMET E KOMPANISË

3.1 PAGA DHE MEDITJE

A PAGAT DHE MEDITJET	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1 PAGAT NETO + SHUJTA	54,623.99	54,415.90	(208.09)	-0.38%
2 KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	3,000.69	2,973.45	(27.24)	-0.91%
3 KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	3,000.69	2,973.45	(27.24)	-0.91%
4 TATIMI NE BURIM	2,511.23	2,079.39	(431.84)	-17.20%
TOTALI	63,136.60	62,442.19	(694.41)	-1.10%

3.2 Tatimet

B TATIMET	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1 TVSH-ja 8%	4,823.62	5,676.61	852.99	17.68%
2 KESTET TREMUJORE (ATK)	-	-	-	-
3 TATIMI VJETOR MBI KORPORATA	-	-	-	-
TOTALI	4,823.62	5,676.61	852.99	17.68%

3.3 MALLRA DHE SHERBIME

C MALLRA DHE SHËRBIME	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1 Shpenzime për karburant	11,122.92	10,998.43	(124.49)	-1.12%
2 Shpenzimet e deponisë (KMDK)	8,311.90	6,281.16	(2,030.74)	-24.43%
3 Shpenzimet për internet	127.12	127.12	-	0.00%
4 Shpenzimet e Mirëmbajtjes së Mjeteve	10,932.71	16,253.81	5,321.10	48.67%
5 Furnizim me Rërë I II III	-	-	-	-
6 Shpenzime për Softuer Kompjuterik	500.00	250.00	(250.00)	-50.00%
7 Shpenzime për zyre dhe administrative	2,167.83	2,960.82	792.99	36.58%
8 Shpenzime për pajisje dhe mjete pune	6,382.35	4,696.37	(1,685.98)	-26.42%
9 Shpenzime për trajnime	-	-	-	-
10 Shpenzimet e Reprezentacionit	436.30	558.40	122.10	27.99%
11 Shpenzimet e Sigurimit	9.03	1,994.62	1,985.59	21988.82%
12 Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	602.40	500.00	(102.40)	-17.00%
13 Provizione Bankare NLB BANK	75.80	118.30	42.50	56.07%
14 Çertifikata për shofer kamioni	-	-	-	-
15 Çertifikata shëndetsore	-	-	-	-

16	Shpenzimet hixhienike		2,442.08	2,442.08	100.00%
17	Uniforma Pune			-	
18	Licence			-	
19	Shpenzimet e punes ne terren				
20	Shpenzimet e pazbritshme per qeshtje tatimor	1,544.00		(1,544.00)	100.00%
21	Shpenzimet e rrymes		158.10	158.10	100.00%
	TOTALI	42,212.36	47,339.21	5,126.85	12.15%

3.4 TOTALI I TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

	TE HYRAT	2024	2025	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	110,450.89	123,877.73	13,426.84	12.16%
2	Te hyra tjera (Ministria e Punes)	3,633.00	452.80	(3,180.20)	-87.54%
3	Paraja në bankë	511.04	1,229.82	718.78	140.65%
	TOTALI	114,594.93	125,560.35	10,965.42	9.57%
	SHPENZIMET				
	Totali i shpenzimeve A+B+C+D+E	110,172.58	115,458.01	5,285.43	4.80%
	Fitimi/Humbja	4,422.35	10,102.34	5,679.99	128.44%



Republika e Kosovës - Republik of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



10/Nr. 5289 2025

DATA :	<u>14/07/2025</u>
PËR :	KPF-Kuvendin Komunal
PËRMES	Mehmet Ballazhi-Kryetarë i Komunës <i>M. Ballazhi</i>
NGA :	Arsim Dernjani-Drejtore i DSHPE-së <i>A. Dernjani</i>
LËNDA :	Informatë mbi sektorin Emergjent



Me këtë shkresë përcjellëse ju informojmë në lidhje me sektorin e emergjencave për periudhën Janar-Qershor 2025.

Ju njoftojmë se gjatë periudhës gjashtë mujore Janar-Qershor 2025, Sektori i Emergjencave ka realizuar një sërë intervenimesh me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe pronës së qytetarëve të Komunës sonë.

Aktivitetet kanë përfshirë menaxhimin e situatave me zjarre, aksidente si dhe ofrimin e ndihmës teknike në raste të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe kanë qenë 21 intervenime në shuarje të zjarreve, ku dy prej tyre kanë qenë në shtëpi banimi dhe të tjerat në fusha dhe male .

RAPORTI I NJËSISË ZJARRËFIKJES DHE SHPËTIMIT JANAR-QERSHOR 2024

2024	Nr. I daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. I daljeve Teknike	Nr. I sherbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të reshura.	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	3	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	5	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	4	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	6	6	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik													
Gusht													
Shtator													
Tetor													
Nëntor													
Dhjetor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	21	21	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Me respekt,